



**N P për veprimtari komunale
"KOMUNALEC"-KËRÇOVË**

**Rruga Tranzite nr. 34, Tel: 071-221-505 Xhirollogaria - 20000003438739,
NVT. 4012989104619 e-mail: jpkomunaleckicevo@gmail.com:**

PROPOZIM PROGRAM

Për punën dhe zhvillimin e Ndërmarrjes Publike për shërbime komunale

"Komunalec"- Kërçovë për vitin 2022

Kërçovë, Dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

1. Të dhëna të përgjithshme
2. Vizioni, misioni, qëllimet
3. Skema organizative

1. TË DHËNAT E PËRGJITSHME

Programin për punën dhe zhvillimin e ndërmarrjes publike për shërbime komunale Komunalec –Kërçovë për vitin 2022 e propozon Drejtorit, e miraton Këshilli Drejtues i NP dhe pëlqim jep Këshilli i Komunës së Kërçovës, në pajtim me nenet 11 dhe 19 nga Ligji për ndërmarrje publike.

Në varësi të nevojave, programi për punë dhe zhvillim do të harmonizohet me mjetet financiare të parapara në buxhetin e Komunës, mjetet financiare të NP, me vendime që do të miratohen nga Këshilli i Komunës, Këshilli Drejtues dhe Komisioni Rregullativ për energjetik i RM.

NP për veprimtari komunale Komunalec- Kërçovë është themeluar me Vendim me nr.08-4936/1 prej më datë 13.11.1989 nga Kuvendi i Komunës së Kërçovës dhe është regjistruar në regjistrin gjyqësor të Gjykatës Themelor Manastirë TREG. Nr.2048/98 prej më datë 13.11.1998.

Me Vendim për të marrë përsipër të punësuarit dhe punën e përgjithshme të Komunave Zajaz, Oslome, Drugovë dhe Vraneshticë, në Këshillin e Komunës së Kërçovës, nr.07-990/4 prej më datë 15.04.2013 Komuna e Kërçovës morri përsipër të drejtat themelore të ndërmarrjeve publike për veprimtari komunale të themeluara nga komunat që bashkohen.

Me vendim për bashkimin e NP Pastërtija – Zajaz, NKP Biser- Vraneshticë, NP Higjiena- Drugovë, NP Higjiena- Oslome, NP Estetika 2002 – Zajaz, nr. 07-1771/5 prej më datë 25.06.2013 nga Këshilli i Komunës së Kërçovës drejt NP KOMUNALEC- Kërçovë, janë të ndërmarrë të punësuarit, të drejtat dhe obligimet e NP që ndërmirren.

Me vendim të Këshillit të Komunës së Kërçovës, nr.07-2770/17 prej më datë 23.05.2013 është ndryshuar dhe plotësuar neni 4 nga vendimi i mëparshëm për bashkim, dhe është caktuar se NP Komunalec i merr obligimet e NP të bashkuara deri në lartësin e mjeteve të siguruar në buxhetin e NP për vitin aktual dhe të ardhurat tjera në pajtim me ligjin të përcaktuara me llogaritë përfundimtare të miratuara të këtyre ndërmarrjeve.

Me Vendimin për zgjedhje të Drejtorit të NP KOMUNALEC- Kërçovë me nr.04-255/1 prej më datë 08.02.2018 nga ana e Kryetarit të Komunës, është zgjedhur Zendel Jonuzi, profesor i diplomuar për mësimdhënie klasore, me mandat prej katër viteve.

Me Vendimin e Këshillit drejtues të NP Komunalec – Kërçovë, nr.02-3773 nga dt.11.12.2013, është sjell Statuti i ri i NP, në dygjuhësi, në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe.

Statuti fitoi pëlqim me Vendimin e Këshillit të Komunës së Kërçovës, nr.07-192/8 prej më datë 29.01.2014, nga kur edhe zbatohet.

Më datë 27.02.2019 nën nr.02-359/8 Këshilli Drejtues i NP miratoi VENDIM STATUTAR për ndryshimin e Statutit të NP "Komunalec"- Kërçovë, me ndryshime neni 15 paragrafi 1 nga Statuti nr.02-3773 prej më datë 11.12.2013, u shtua veprimtari e re 52.21 Aktivitete të tjera shoqëruese në komunikacionin tokësor (parkimi)

Këshilli i Komunës së Kërçovës, me Vendim nr.08-957/7 prej më datë 23.04.2019 dha pëlqim për Vendimin statutar për ndryshimin e Statutit të NP "Komunalec"- Kërçovë.

Në vitin 2018 është marrë Pëlqim me Shkrim nga Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës me nr.12/6-2979/2 më datë 30.04.2018 për Rregulloren për organizimin e brendshëm të NP "Komunalec" Kërçovë me nr.01-831/1 më datë 25.04.2018, i miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues,nr.02-919/1 prej më datë 10.05.2018 dhe Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës të NP "Komunalec" Kërçovë nr. 01-831/2 prej më datë 25.04.2018 e miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues, nr.02-919/5 prej më datë 10.05.2018.

Më datë 29.07.2021 Këshilli Drejtues me Vendim nr.02-1302/5 e miratoi raportin nga analiza funksionale e NP "Komunalec"- Kërçovë për vitin 2021, i cili me Konklusion nr.08-2236/8 prej më datë 27.09.2021 nga Këshilli i Komunës së Kërçovës është miratuar.

Çka është Analiza Funksionale?

Analiza funksionale paraqet analizën e funksioneve themelore dhe thelbësore të një organizate, përkatësisht mjet për menaxhim me ndryshimet. Analiza funksionale nuk ofron zgjidhje për zgjidhjen e problemit ose mangësive eventuale, dhe as zgjidhje të plotë të së njëjtës, por thjesht, kryen skanimin dhe shqyrtimin e gjendjes momentale, dhe pastaj përmes analizës jepen vërejtje dhe rekomandime të caktuara për të cilat a do të pranohen ose jo, vendos Drejtori i NP.

Qëllimi i analizës funksionale është forcimi i efikasitetit dhe efektivitetit të NP "Komunalec" - Kërçovë, dhe fokusohet në një ose më shumë nga qëllimet e mëposhtme:

- ti identifikojë pyetjet kryesore lidhur me organizatën dhe me funksionimin e institucionit
- të propozojë masa konkrete për përmirësimin e efikasitetit institucional
- kryerja e detyrimeve ligjore për përgaditjen e analizës funksionale, që del nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik.

Më shpesh, analiza funksionale miratohet kur gjatë kryerjes së kompetencave themelore dhe funksioneve (sigurimi i shërbimeve), organizata përballet me efikasitet dhe efektivitet të pamjaftueshëm në organet shtetërore, organe dhe institucione si rezultat nga vendosja e përhershme e organizimit të brendshëm dhe kapacitetit të punëtorëve.

Pse zbatohet analiza funksionale në NP "Komunalec"- Kërçovë?

Zbatimi i analizës funksionale në NP "Komunalec"- Kërçovë paraqet një nga kushtet ligjore për përgaditjen e aktit për organizimin e brendshëm dhe akti për sistematizimin e vendeve të punës. Domethënë, në përputhje me nenin 17 paragrafet 2 dhe 3 nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik Aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimi miratohen në bazë të analizave funksionale. Në aktet për sistematizimin e vendeve të punës mund të sistematizohen më së shumti 10% vende pune nga vendet e punës për të cilët janë siguruar mjete financiare për rroga dhe kompenzime në buxhetin e institucionit, përveç për institucionet me më pak se 30 të punësuar, në të cilën mund të sistematizohen deri 50 vende pune, nëse ka rritje të kompetencave të institucionit në përputhje me ligjin kur numri i vendeve të punës vërtetohet në përputhje me analizën funksionale.

Analiza funksionale paraqet hulumtim që synon forcimin e efikasitetit dhe efektivitetit të administratës publike. Procesi përfshin mbledhjen e informacioneve në lidhje me funksionet që kryhen nga ana e institucioneve të sektorit publik për të analizuar qëllimin, organizatën dhe të punësuarit. Ai lidh objektivat strategjike për ndryshim dhe evaluimin e kapaciteteve ekzistuese të institucioneve të sektorit publik duke dhënë informacione të detajuara për menaxhimin e mirë të tyre.

Cili është qëllimi përfundimtar i analizës funksionale në NP "Komunalec" - Kërçovë dhe cilat janë hapat e mëtutjeshëm?

Analiza funksionale është hapi i parë dhe fillestar në fillimin dhe vendosjen e ndryshimeve në vendosjen e brendshme dhe kryerjen e proceseve të punës në NP "Komunalec" - Kërçovë. Përveç proceseve të panevojshme të punës, analiza tregon se cilat njësi organizative dhe proceset e punës nuk janë efikase dhe efektive, dhe për pasojë duhet të shfuqizohen, zhvendosen, plotësohen, ndryshohen etj. Raporti nga kjo analizë përmban rekomandimet konkrete, implementimi i të cilave çon në rezultate konkrete në drejtim të përmirësimit të proceseve të brendshme të punës në ndërmarrje.

Pas pranimit të këtij Propozimi - Raporti për analizë funksionale, është e nevojshme që në NP "Komunalec" - Kërçovë të implementohen rekomandimet e propozuara që Ministria i konsideron të pranueshme. Një nga hapat kryesorë është përputhshmëria e akteve të reja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Megjithatë hapi i parë dhe më i rëndësishëm, nuk është dhe nuk duhet të jetë i vetmi që është ndërmarrë. Në atë drejtim, është e nevojshme që rekomandimet e tjera të Raportit të implementohen për të arritur qëllimin - një ndërmarrje publike efikase dhe efektive, e gatshme të përballet me sfidat.

STRUKTURA E RAPORTIT

Ky raport fillon me shpjegimin e metodologjisë së shfrytëzuar (instrumenteve) gjatë zbatimit të analizës funksionale në NP "Komunalec"- Kërçovë (në tekstin e mëposhtëm: Ndërmarrja).

Analiza jep shqyrtim të punëve (kompetencave) të Ndërmarrjes sipas njësive organizative dhe përmbushjes së vendeve të punës. Të dhënat e potencuara janë të marra nga aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, si dhe nga matricat e përmbushura me detyra pune që kryhen në praktikë dhe që janë të plotësuara me rezultatet e arritura deri në Maj 2021 dhe procedurat egzistuese me shkrim.

Rezultatet e hulumtimit të kryer në Ndërmarrje si pjesë e kësaj analize funksionale paraqiten në një pjesë të veçantë. Të njëjtat janë të paraqitura përmes grafikëve dhe rrëfimit.

Së fundmi, ekzistojnë elementet kryesorë të Raportit dhe të analizës funksionale në përgjithësi - vërejtjet dhe rekomandimet. Ato dalin nga instrumentet e përdorura siç janë: shqyrtimi i punëve (kompetencave) të Ndërmarrjes nga rregulloret dhe dokumentet e tjera, rezultatet e marra nga hulumtimi dhe informacionet e fituara nga intervistat e kryera.

Siç është vërejtur, çdo vërejtje shoqërohet nga një rekomandim i cili nga ana e tij tregon nevojën për ndryshim dhe përmirësim në funksionimin e Ndërmarrjes.

METODOLOGJIA

Theksohet se nuk egziston asnjë metodologji e pranuar përgjithësisht për zbatimin e analizës funksionale. Metodologjia e cila implementohet gjatë zbatimit të kësaj analize funksionale bazohet në praktikat më të mira, me rregullime të caktuara në specifikat e organeve shtetërore, organeve dhe institucioneve në sistemin e Republikës së Maqedonisë Veriore, siç është NP "Komunalec" - Kërçovë.

Rekomandime për trajnime për të punësuarit e NP "Komunalec"- Kërçovë

Për t'i kushtuar më shumë vëmendje zhvillimit profesional të punësuarve në NP "Komunalec"- Kërçovë. Në përputhje me nenin 54 paragrafi (1) nga Ligji për nëpunësit administrativ (që ka të bëjë me nëpunësit administrativ në ndërmarrjen publike) nëpunësi administrativ ka të drejtë dhe detyrim gjatë vitit profesionalisht të trajnohet në bazë të planit individual për trajnim profesional, si dhe për detyrë që të transferojë njohuritë e fituara tek nëpunësit administrativ të tjerë. Trajnimet për trajnim profesional të nëpunësve administrativ mund të jenë generike dhe të specializuara dhe të njëjtat mund të organizohen nëpër klasa ose përmes qasjes në internet nga vendi i punës i nëpunësit administrativ deri në sistemin elektronik për menaxhim me trajnimet. Trajnimet gjenerike kryhen për shkak të

zhvillimit profesional të nëpunësve administrativ në përputhje me kornizat e kompetencave të përgjithshme. Në bazë të trajnimeve nga planet individuale për zhvillim profesional, drejtori i ndërmarrjes publike duhet të përgadisë plan vjetor për trajnime të të gjithë nëpunësve administrativ në institucion dhe të njëjtën, pas marrjes së mendimit nga Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës, ta sjellë atë jo më vonë se 31 Dhjetor i vitit aktual për vitin e ardhshëm. Drejtori është i detyruar dy herë në vitë, jo më vonë se 15 Korrik për periudhën Janar-Qershor, përkatësisht më vonë deri më 15 Janar për periudhën Korrik-Dhjetor, deri tek Ministria të dërgojë raporte për realizimin e planit. Këto janë detyrime që NP "Komunalec"- Kërçovë duhet ti plotësojë.

Anëtarë i jashtëm për përgaditjen e Raportit për analizë funksionale është Jugoslav Gjorgjievski nga Shkupi.

Nga Qeveri e Republikës së Maqedonisë së Veriut është dërguar letër nr.0302-179/2 prej më datë 30.08.2021 me numër arkivi 08-4374/2 deri tek kryetari i Sutkoz dhe kryetari i shoqërisë të dhënësit të shërbimeve komunale ADKOM është dërguar përgjigje për iniciativën për rimarrjen e NPK nga Ligji për nëpunës administrativ dhe Ligjit për të punësuarit në Sektorin publik, se Qeveria jep përgjigje pozitive për iniciativën dhe se përmes ndryshimeve përkatëse të përmbajtura në Propozim ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe Propozim Ligjin për nëpunësit administrativ që do të jenë të përgaditura në kuartalin e ardhshëm se ndërmarrjet publike për veprimtari komunale dhe të punësuarit e tyre do jenë jashtë fushëveprimit të punëdhënësve dhe të punësuarve në sektorin publik. Për shkak të arsyeve dhe pritjeve të potencuara të realizohen ndryshimet për ligjet e përmendura, NPK janë në gjendje të pazgjidhur juridike, gjë që shkakton vështirësi të mëdha në punën e tyre të përditshme.

VIZIONI

- Ndërmarrje e suksesshme publike në fushën e furnizimit me ujë, largimin e ujërave të zeza urbane, grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave komunale, pastrimin e ujërave të zeza, menaxhimi me Varrezat Ortodokse (të vjetra dhe të reja) ,shërbimet e tregut dhe menaxhimi me parkingjet publike të potencuara në Statutin e NP.

MISIONI

- Modernizimi i punës dhe orientimin drejt përdoruesëve përfundimtarë të shërbimeve komunale, në kuptimin e plotësisht të nevojave të cilësisë të ujit të pijshëm të shëndetshëm 24 orë në ditë, riparim në kohë i defektet të rrjeteve,, grumbullimin në kohë, transportimin e mbeturinave komunale, mirëmbajtjen e higjienës publike dhe hapësirave të gjelbra në pajtim me Programet.

- Ndërtimi i linjave të reja të ujit dhe kanalizimit, si dhe zëvendësimi i linjave të vjetra si kusht për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve komunale për territorin e Komunës së Kërçovës.
- Vendosja dhe pagesa e shërbimeve për parkingjet e qytetit në Komunën e Kërçovës
- Futja në sistemin e pagesave të shfrytëzuesve të shërbimeve komunale nga rajonet e Zajazit, Oslomes, Drugovës dhe Vraneshticës.
- Zhvillim i planifikuar dhe i qëndrueshëm duke zbatuar vazhdimisht ide inovative dhe respektimin e parimeve ekologjike.
- Zgjidhje e përhershme e mbledhjes, selektimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave komunale të pa rrezikshme.

QËLLIMET

- Zbatimi i programit vjetor të punës dhe zhvillimit për vitin 2022
- Distribrimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm me më pak humbje ekonomike dhe teknike
- Zbatimi i GIS, sistemet SKADA, E -kadastar
- Zbatimi i procedurave për punë
- Zbatimi i vendimeve të Komisionit Rregullator të Energjisë për përcaktimin e tarifave për ujë të pijshëm, për largimin e ujërave të zeza urbane dhe për trajtimin e ujërave të zeza
- Rritja e përqindjes së pagimit të ujit të pijshëm të harxhuar dhe shërbimeve tjera komunale, futjen e sistemit të pagesës së fshatrave nga komunat e bashkuara dhe masave tjera për pagesë efektive të kërkesave të kryera të shërbimeve komunale
- Mirëmbajtja e hapësirave për parkim dhe vendosja e rregullshmërisë në komunikacionin stacionar të qytetit. Për nevojat e shërbimit parkimi, njësia për ndërtim duhet që ti përshtasë, rregullojë dhe kryej hapësira për parkim, në përputhje me projektin i përpunuar nga Komuna e Kërçovës. Është e nevojshme instalimi i pajisjeve urbane dhe të vizatohen sinjalizimet horizontale me që do të potencohet qëllimi i ri për këto hapësira. Detyra e të punësuarve në Sektorin për mirëmbajtjen e parkingjeve publike sëbashku me njësinë për ndërtim është edhe mirëmbajtja edhe rivendosja të së njëjtave. Me shfaqjen e trendit për rritjen e shkallës motorike dhe numrit të automjeteve mekanike të regjistruara në qytet, me çdo kusht është e dukshme nevoja për parkingjet publike dhe mirëmbajtjen e hapësirave për parkim me qëllim

për tu përballuar me situatën e re. Detyra e shërbimit Merimangë, që do të jetë Njësi për ngritjen e veturave në Sektorin për mirëmbajtjen e parkingjeve publike është që të ndihmohet në rregullimin e komunikacionit dhe parandalimin e parkimit të paligjshëm dhe jo të duhur ku parkimi më tej mund të shkaktojë ndërprerje të rrjedhës normale të trafikut dinamik dhe funksionimin e qytetit në tërësi. Shërbimi merimangë do të punojë me bashkëpunim edhe në urdhëra të policisë.

- Mirëmbajtja në funksion i stacionit të filtrimit për ujërat e zeza urbane dhe rregullimin e procedurave ligjore për statusin e objektit (pronësia, financimi dhe etj).
- Përmirësimin e efikasitetit të menaxhimit ditor me defekte të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe të gjithë llojet e defekteve të automjeteve motorike.
- Furnizim të automjeteve të reja për mallra dhe automjete të terrenit
- Ndërtim i linjave të reja të ujësjellësit dhe kanalizimit, për furnizim më efikas të zonave kritike në Komunë
- Vendosja e pajisjeve urbane dhe kontejnerë për mbeturina, për mjedis të pastër jetësor.

LLOJI DHE NUMRI I FORMAVE ORGANIZATIVE

Drejtor

- **Ndihmës drejtori për çështje juridike, financiare dhe komerciale**
- **Ndihmës drejtori për çështje teknike**
- **Këshilltar i Pavarur i Drejtorit**

(1) Në kuadër të NP si njësi të pavarura organizative formohen

- 1.Njësia për mbështetjen e drejtorit**
- 2. Njësia për revizionin e brendshëm**

(2) Në Ndërmarrjen organizohen sektoret dhe njësit si vijojn

1. SEKTORI PËR ÇËSHTJET JURIDIKE, TË PËRGJITHSHME DHE BURIMEVE NJERËZORE

- 1.1 Njësia për çështjet juridike dhe të përgjithshme
 - 1.1.1 Njësia për çështje të përgjithshme
 - 1.2 Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore
 - 1.3 Njësia për sigurim

2. SEKTORI FINANSIAR, KONTABILITETIT DHE KOMERCIAL

- 2.1 Njësia për çështjet financiare dhe kontabilitetit
- 2.2 Njësia për çështje komerciale
- 2.3 Njësia tregu

3. SEKTORI PËR FURNIZIME PUBLIKE

- 3.1 Njësia për furnizime publike
- 3.2 Njësia për përdorimin e SEPP

4. SEKTORI PËR PAGESËN E KËRKESAVE

- 4.1 Njësia për vërtetimin dhe pagesën e kërkesave
- 4.2 Njësia për ndërprerjen e shërbimeve komunale

5. SEKTORI PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE DHE TEKNOLOGJISË INFORMATIKE

- 5.1 Njësia për zhvillim
- 5.2 Njësia e teknologjisë informatike

6. SEKTORI PËR UJËSJELLËSIN, KANALIZIMIN DHE NDËRTIMIN

- 6.1 Njësia për kontrollim sanitar dhe dezinfektimin e ujit
- 6.2 Njësia për mirëmbajtjen e ujësjellësit - Kërçovë
- 6.3 Njësia për mirëmbajtjen e ujësjellësit – Zajaz
- 6.4 Njësia për mirëmbajtjen e ujësjellësit – Oslome
- 6.5 Njësia për ndërtimin dhe bartjen e ujërave të zeza urbane
- 6.6 Njësia për pastrimin e ujërave të zeza urbane
- 6.7 Njësia për ndërtim

7. SEKTORI PËR HIGJENËN KOMUNALE

- 7.1 Njësia për grumbullimin, transportin, deponimin dhe selektimin e mbeturinave komunale
- 7.2 Njësia për mirëmbajtjen e parqeve në sipërfaqe publike
- 7.3 Njësia për menaxhimin me varrezat

8. SEKTORI MEKANIZIMI

- 8.1 Njësia për mirëmbajtje
- 8.2 Njësia Qendra për komunikim

9. SEKTORI PËR MIRËMBAJTJEN E PARKINGJEVE PUBLIKE

- 9.1 Njësia për parkingjet publike
- 9.2 Njësia për ngritjen e automjeteve (njësia merimangë)

Veprimtaritë themelore të NP janë

- 36.00 – grumbullimi, përpunimi dhe furnizimi me ujë
- 37.00 – largimi i ujërave të zeza
- 38.11 – grumbullimi i hedhurinave jo të rrezikshme
- 47.82 - Tregti e tezgave me pakicë dhe tregu
- 81.30 - Shërbimet e detyruara për rregullimin dhe mirëmbajtjen e ambientit jetësor
- 96.03 – Varrime dhe veprimtari të ngjajshme
- 52.21 – Aktivitete të tjera shoqëruese në komunikacionin tokësor

Organet e ndërmarrjes janë:

- Këshilli Drejtues
- Këshilli për kontrollin e punës materiale dhe finansiare
- Drejtori

Me Vendim të Këshillit Drejtues nr.02-2504/7 prej më datë 29.12.2017, është përcaktuar kompenzimi për çdo mbledhje të mbajtur për anëtarët e KD, me shumë prej 3.500,00 denarë, për anëtarët e KM me shumë prej 2.500.00 denarë, për personat e autorizuar për përgaditjen e materialeve për mbledhjet dhe përkthimin e të njejtave nga 2.500.00 denarë për çdo mbledhje të mbajtur.

Gjithsej 241 të punësuar, me gjendje deri më datë 31.12.2021, pa Drejtorin.

Në bazë të kombësisë- 93 -Maqedonas, 95- Shqipëtar, 23- Turq, 24- Rom Gjithsej 241+1 (drejtor Shqipëtar)

Gjinia- 22 Gra (14- Maqedonase, 8- Shqipëtare)

Sipas Rregullores së re për sistematizimin e vendeve të punës janë:

Nëpunës administrativ – 40 nëpunës publik

Dhënës të shërbimeve publike- 117 të punësuar

Personel ndihmës teknik- 84 të punësuar

Në bazë të përgaditjes profesionale Shkalla VIII – **1**, Shkalla VII (240 kredi) – **14**, Shkalla VII (210 kredi) – **1**, Shkalla VII (180 kredi)-**6**, shkalla VI-**4**, Shkalla V-**1**, Shkalla IV- **71**, Shkalla III- **35**, Shkalla II **100**, Shkalla I- **7**, shkalla 0 (të pa arsimuar) -**3**

Ndërprerje e marrëdhënies së punës për shkak të plotësimit të kushteve për pensionim me 64 vjet për vitin 2022 ka 8 të punësuar, kurse tre të punësuar i kanë përmbushur kushtet për pensionim, me deklaratë e kanë vazhduar marrëdhënien e punës edhe në vitin 2022.

1. SEKTORI PËR ÇËSHTJE JURIDIKE, KADROVIKE DHE TË PËRGJITHSHME

Në përputhje me Rregulloren për organizimin e brendshëm të NP „Komunalec” Kërçovë me nr. 01-831/1 prej më datë 25.04.2018 është organizuar

1.1 Njësia për çështjet juridike dhe të përgjithshme

1.1.1 Njësia për çështje të përgjithshme

1.2 Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore

1.3 Njësia për sigurim

Sektori gjithsej me Drejtorin dhe ndih.drejtorin numëron **19 realizues**, 1 drejtor (person i emëruar), ndihmës drejtor për çështje juridike dhe ekonomike-1, 7 punëtor administrativ-nëpunës publik, 9 realizues ndihmës teknik dhe 1 realizues i punësuar për kohë të caktuar.

Sektori për çështje të përgjithshme, juridike dhe burime njerëzore për vitin 2020 i vendosi të dhënat e të punësuarve në regjistrin elektronik për të punësuarit në sektorin publik që e mirëmban Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, derisa në vitin 2022 do të përgadisë Plan për punësim në përputhje me rregullat ligjore, nëse NPK nuk do të merren nga Ligji për Punëtorët Administrativ dhe Ligji për të punësuarit në Sektorin publik.

Në vitin 2020 u përgaditën vendime për të gjithë të punësuarit në përputhje me Rregulloren e re për organizimin e brendshëm të Ndërmarrjes publike për veprimtari komunale “Komunalec”- Kërçovë nr.01-831/1 prej më datë 25.04.2018, Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës nr.01-831/2 prej më datë 25.04.2018 dhe Rregullore për pagën primare dhe shtesat në pagë për të punësuarit, derisa në vitin 2022 do të miratohet të gjitha aktet nënligjore për implementim dhe zbatim praktik i Ligjit për nëpunësit administrativ dhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik.

Sektori për çështje të përgjithshme, juridike dhe burimeve njerëzore në vitin 2022 do të ndjekë, interpretoj dhe zbatoj të rregullat ligjore të lidhura me veprimtarinë dhe punën e NP, përgatitjen e akteve, rregulloreve, vendime, kontrata, vërtetime, raporte, letra dhe akte tjera për korrespondentë, parashtrimin e të gjitha llojeve të padive për personat fizikë dhe juridikë, kundërshtime, ankesa, kërkesa për përmbarim, si dhe përfaqësim të NP para gjykatave, kompletimin e lëndëve gjyqësore dhe udhëheqjen e evidencës, përgatitjen e materialeve për mbledhje të Bordit Drejtues dhe Bordit mbikqyrës, procedura për themelim dhe ndërprerje të marrëdhënieve të punës, aktvendime që i sjellë drejtori në lidhje me marrëdhënien e punës, procedura për qasje të lirë deri te informatat e karakterit publik, siguri dhe shëndet i punëtorëve, sigurim fizik i objekteve dhe mjete themelore, dorëzim dhe pranimit të postës, punë të arkivimit, mirëmbajtje të higjienës të hapësirave afariste dhe të punës, punë të tjera pas urdhëresës së drejtorit dhe ndihmës të drejtorit.

Për vitin 2022 Sektori për çështje të përgjithshme, juridike dhe burimeve njerëzore do të udhëheqë procedurën për

- Importimin e pronës së tërësishme të patundshme me të cilën menaxhon ndërmarrja në AKP të RM-së, procedura ka filluar para Ministrisë së Financave, Drejtoria për çështje të pronës, Njësia rajonale në procedurë në shkallë të parë – Kërçovë nën numrin 26-722 prej më datë 26.11.2014, si dhe procedura për legalizimin e objekteve të ndërtuara dhe është në vazhdimësi, përshkak të procedurave gjyqësore dhe administrative.
- Dakordimin e akteve me Ligjin për Punonjësit e Sektorit Publik dhe Ligjin për nënpunësit Administrativ pas marrjes së pëlqimit të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Ndërmarrjes Publike Komunalec-Kërçovë dhe Rregullores për Sistematizimin e vendeve të punës në Ndërmarrjen Publike Komunalec Kërçovë nga ana e Ministrisë së Shoqërisë Informatike ose nëse NPK do të merren do zbatohet procedurë për kthim nën LMP.
- Përgatitja e Rregulloreve të posaçme për siguri dhe shëndet dhe përgatitje e personave për dhënien e provimit për person të autorizuar për siguri dhe shëndetësi gjatë punës.
- Përgatitja e procedurave për punë në përputhje me Rregulloren e re për sistematizim dhe raporti i ESHP
- Përfundimi i procedurave për fshirjen nga regjistri qendror të NP të bashkangjitura
- Të parashtrihen kërkesa për përmbarim deri te përmbaruesi, për Aktvendime të plotëfuqishme, me të cilat lejohet përmbarim.
- Parashtrim i propozimeve tek noteri për lëshim të vendimeve për urdhëresa pagese noteri për borxhe të pa paguara të personave juridik dhe fizik në përputhje me ligjin e ri.
- Punë aktuale

2. SEKTORI EKONOMIK-KOMERCIAL

Në përbërje të Sektorit Ekonomik-komercial janë Seksioni komercial dhe Njësia për furnizime publike. Udhëheqës i Sektorit Ekonomik-komercial është Ardit Ramadani, Ekonomist i diplomuar, kurse Sektori është nën kompetencën e drejtpërdrejt të Ndihmës drejtorit për çështje juridike, financiare dhe komerciale dhe Drejtorit të ndërmarrjes.

Vendosja organizative sipas vendeve të punës është si vijon:

- Referent më i ri-Konter – 1 realizues
- Referent për likvidim– 1 realizues
- Referent i lartë-Kontabilist i pavarur– analist – 1 realizues
- Referent- Evidenc materiale dhe financiare – 1 realizues
- Referent për llogaritjen e rrogave- 1 realizues
- Referent më i ri- Arkëtar- 1 realizues
- Referent i lartë- Magazinier kryesor i mallrave – 1 realizues

Njësia komerciale:

- Bashkëpunëtor përgjegjës për plan dhe analizë – 1 realizues
- Këshilltar për kontrollimin e furnizimeve publike – 1 realizues

Njësia tregu

- Udhëheqës i njësisë – 1 realizues
- Inkasant-pagesues- 1 realizues
- Roje – 1 realizues
- Roje-Roje zjarrfikës me liçencë-2 realizues
- Pastrues- 1 realizues

Gjatë vitit 2022, Sektori Ekonomik-Komercial do të realizojë aktivitetet vijuese:

- Aktivitete të rregullta si pranime, likvidime, shtypje dhe dhënie të pasqyrave dhe bilanseve për gjendjet e përgjithshme në periudhën vijuese; udhëheqje e përditshme e punëve arkëtuese – përgaditje e raporteve të arkave, evidentim dhe azhurim; pagesa e rrogave, tatimeve dhe kontributeve nga rroga; kujdeset për dorëzimin në kohë të dokumenteve financiare nga seksioni për komercijalitet dhe seksioni për furnizim publike; evidencë të pranimeve dhe dërgesave në materiale analitike.

- Aktivitete periodike si hartimi i përlllogaritjes tre mujore, gjashtë mujore dhe nëntë mujore ku përgaditet bilans për gjendjen, bilanc për arritje dhe bilanc tatimor. Vend të rëndësishëm merr edhe pajtueshmëria e vazhdueshme e kërkesave dhe obligimeve me komitentët në kontot përkatëse nëpërmjet dhënies së konfirmimeve gjatë së cilës do të sjell të dhëna të sakta dhe kualitative për përgaditjen e raporteve periodike dhe raporteve vjetore.

Aktivitete lidhur me përgaditjen e llogarisë vjetore si regjistrimi i mjeteve themelore, kërkesat dhe obligimet, mjete, objekte ndërtimore, vërtetimi i mangësive ose tepërsive sipas regjistrimit dhe përgatitje të Raportit Financiar të ndërmarrjes.

Plani vjetor përbëhet nga më shumë njësi llogaritëse edhe atë:

1. Plan për prodhim dhe shërbime
2. Plan për kapacitete të disponueshme dhe shfrytëzimi i tyre
3. Plan për formim dhe shpërndarje të të ardhurave të përgjithshme
4. Plan për përcaktimin e harxhimeve nga puna.

1. PLAN PËR PRODHIM DHE SHËRBIME

Për arsye se ndërmarrja jonë të ardhurat e përgjithshme i realizon nga shërbimet, në pasqyrën e ardhshme do të jenë të shfrytëzuara treguesit planor –parashikimet për realizimin e shërbimeve për njësi punuese.

		Realizuar 2021	Planifikuar 2022	Përqindje
1	UJËSJELLËSI, kanalizimi dhe ndërtimi			
	Distribuimi i ujit	36.991.799,00	40.690.979,00	10%
	Montimi dhe mjetet	222.835,00	245.118,00	10%
	Kuçjet	2.633.339,00	2.896.672,00	10%
	Kanalizimi	6.039.699,00	6.643.669,00	10%
2	STACIONI PËR PASTRIMIN E UJËRAVE TË ZEZA			
	Pastrimi i ujrave të zeza	9.790.899,00	10.769.989,00	10%
3	HIGJIENA KOMUNALE			

	Mbledhje e mbeturinave, oxhaqeve, pastrimi i gropave të kanalizimit etj.	42.356.315,00	46.591.946,00	10%
	Shërbime varrimi	3.766.964,00	4.143.660,00	10%
	Pastërtia publike	5.081.440,00	5.589.584,00	10%
4	NDËRTIMTARI			
	Punë ndërtimore dhe shërbime	1.901.860,00	1.996.953,00	10%
5	TREGU			
	Tregu i gjelbërt	583.470,00		
6	Shpenzime manipulative			
7	Të ardhura nga qiratë	268.272,00		
8	Materiale tepricë			
9	Të ardhura tjera	651.972,00	717.169,00	10%
10	Të ardhura nga viti kaluar			
11	Të ardhura në bazë të kamatave	252.945,00	278.239,00	10%
12	Hidro të vogla	4.619.155,00	5.081.070,00	10%
13	Të ardhura tjera	300.764,00	330.840,00	10%

2. PLAN I KAPACITETEVE TË DISPONUESHME

Me këtë plan, jepet shqyrtim i tërësishëm i mundësive të pajisjeve dhe montimeve në kushte normale që të sigurojë grumbullim normal të prodhimeve dhe shërbimeve.

Gjithsej kapacitete	Të realizuara 2021	Të planifikuara 2022	Përqindja
Tokë ndërtimore	2,181,738,00		
Ujësjiellësi	677.401.420,00	745.141.562,00	10%
Mobilje, makineri, kompjutera dhe mjete transportuese	99.924.697,00	109.917.167,00	10%

3. PLAN PËR FORMIMIN DHE SHPËRNDARJEN E TË ARDHURAVE TOTALE

Të ardhurat totale formohen nga realizimi i faturuar. Nga të ardhurat totale të faturuara mbulohen të gjithë harxhimet e punës dhe amortizimi në shkallë minimale të shënuara.

PLAN I TË ARDHURAVE TË PËRGJITHSHME DHE SHPËRNDARJA E TYRE

	Të realizuara 2021	Të planifikuara 2022
Gjithsej të ardhura	115.461.728,00	127.007.901,00
Shpenzime materiale	23.083.975,00	25.392.373,00
Amortizim	16.990.920,00	18.690.012,00
Rroga dhe shpenzime tjera	60.017.766,00	66.019.543,00

Planifikohet të ardhurat e përgjithshme në vitin 2022 të rriten për 10% në krahasim me vitin 2021, shpenzimet materiale për 10% ndërsa amortizimi për 10% dhe harxhimet tjera për 10 %.

4. PLAN PËR PËRCAKTIMIN E HARXHIMEVE NGA PUNA

Planifikimi i shpenzimeve nga puna kryhet në bazë të harxhimeve të realizuara në periudhën paraprake. Volumi i detyrave të planifikuara, normativat për shpenzim, si dhe dispozitat ligjore.

Plan për harxhimet e punës

Konto	Elemente	Të realizuara 2021	Të planifikuara 2022	Përqindje
400	Materiale harxhuese	1.463.683,00	1.610.051,00	10%
401	Materiale harxh.kanc	112.578,00	123.836,00	10%
403	Harxhime për energji elektrike	3.167.333,00	3.484.066,00	10%
404	Harxhime për pjesë rezerv	1.783.721,00	2.678.757,00	10%
408	Çregjistrim i inventarit të vogël	269.719,00	283.205,00	5%
410	Harxhime për komunikacion			
411	Shërbime telefonike	444.217,00	488.639,00	10%
412	Shërbime tjera	2.468.045,00	2.714.849,00	10%
415	Harxhime për furn.me ujë. STUDENÇICA	10.014.972,00	11.016.469,00	10%
417	Harxhime për reklama dhe promovime	21.288,00	23.417,00	10%
419	Shërbime tjera	618.737,00	680.611,00	10%
421	Rroga bruto	59.138.278,00	65.052.106,00	10%
422	Harxhime tjera për të punësuarit	850.905,00	935.995,00	10%
430	Amortizimi	16.990.920,00	18.690.012,00	10%
440	Mëditje për udhëtime zyrtar	28.583,00	31.441,00	10%

441	Dhurata për të punësuarit			
442	Harxhime për Këshillat drejtues dhe mbikqyrës	390.014,00	429.015,00	10%
443	Harxhime për donacione dhe sponsorime	-	-	
444	Harxhime për reprezentim	191.353,00	210.488,00	10%
445	Polisa e sigurimit	359.448,00	395.393,00	10%
446	Shërbime bankare	170.934,00	188.027,00	10%
447	Taksat gjyqësore	485.431,00	533.974,00	10%
449	Shërbime për notarin dhe të tjera	860.180,00	946.198,00	10%
474	Kamatat bankare	256.869,00	282.556,00	10%
479	Të ardhura tjera financiare	5.453,00	5.726,00	5%

3. SEKTORI PËR FURNIZIME PUBLIKE

Aktivitetet e planifikuara të sektorit për furnizime për vitin 2022 janë:

- Procedura për realizim të furnizimeve publike për nevojat e njësisë punuese të NP "Komunalec" – Kërçovë në pajtim me LFP dhe plani i miratuar i furnizimeve nga ana e këshillit drejtues i NP Komunalec për vitin 2022.
- Procedura për furnizim publik përfshin:
 - Përgatitja e Dokumentacionit të Tenderit (me kërkesë të paraqitur - me specifikime teknike nga udhëheqësi i Sektorit, NJP, njësisë dhe të ngjajshme të miratuara nga personi përgjegjës në NP Komunalec - Kërçovë)
 - Publikimi i Shpalljes në SEPP dhe në Buletinin Evropian (ku sipas LFP-së është i detyrueshëm)
 - Evaluimi i procedurave, zbatimi i e-Aukcioneve
 - Propozim për zgjedhjen ose anulimin e procedurave ose pjesë nga procedura
 - Përzgjedhja e ofertuesve
 - Anulimi i procedurave
 - Përgatitja e Kontratave ose Marrëveshjes Kornizë
 - Përgatitja e marrëveshjeve individuale në bazë të Marrëveshjes Kornizë

- Evidentimi i kontratave të nënshkruara njoftime të duhura
 - Përgatitja e dokumentacionit të përshtatshëm për pjesëmarrjen e Ndërmarrjes Publike "Komunalec" - Kërçovë në shpalljet e publikuara nga persona të tjerë juridik
 - Trajnime për të punësuarit në NP "Komunalec" - Kërçovë për fushën e furnizimeve publike

Përshkrimi i aktiviteteve	Numri i personave	Mjetet financiare në den.
Trajnimi i stafit në fushën e furnizimeve publike dhe dhënia e provimit profesional me marrjen e certifikatës për personin e trajnuar	3	trajnime
		Harxhime rrugore
		ditore
Seminare	3 persona për 3 seminare	seminar
		Harxhime rrugore
		mëditje
Furnizimi i certifikatave digjitale-tokena	3x5.600	16.800,00 denarë
Financimi i përgjithshëm i planifikuar për trajnime dhe seminare		116.800,00 denarë

PLAN VJETOR TË FURNIZIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2022 TË NP
për veprimtari komunale "KOMUNALEC" - Kërçovë

(emri i organit kontraktues)

Nr.	Lënda e kontratës për furnizime publike/marrëveshja kornizë	Fillimi i pritur i procedurës (muaji)	Vlera e vlerësuar e kontratës/marrëveshjes kornizë pa TVSH(denarë)	Lloji i procedurës
1	2	3	4	5
	I. Kontrata dhe marrëveshje kornizë për furnizim publik të mallrave			
1.1	Mallra të ndryshëm	Janar	900000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.2	Rizëll dhe gurë për muratim	Janar	3000000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.3	Energji elektrike	Janar	7000000	Procedurë e hapur
1.4	Gypa për kanalizim dhe kapakë për shahta	Janar	4200000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.5	Pllaka betoni , anësore dhe Beton i gatshëm	Shkurt	3000000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.6	Vaksinimi kundër viruseve	Shkurt	100000	Furnizim i vogël
1.7	Automjet tereni me fuqi me të gjithë rrotat- e përdorur	Shkurt	930000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.8	Riparimi i automjeteve speciale për transport të mbeturinave komunale në Automjet bartës-kiper	Shkurt	500000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.9	Ngjyrë për shënimin e rrugëve	Shkurt	800000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.10	Materiale për zyra	Shkurt	800000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.11	Servisimi i printerëve	Shkurt	300000	Furnizim i vogël
1.12	KLOR dhe sistem për dozimin e klorit të gazit dhe Hipoklorur natriumi	Shkurt	600000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.13	Fshesë-e re	Shkurt	6000000	Procedurë e hapur
1.14	Gypa hidraulik	Shkurt	300000	Furnizim i vogël
1.15	Mjete (vertikale dhe horizontale) për parkingje	Shkurt	500000	Furnizim i vogël
1.16	Automjet zyrtar pasagjerësh- e re	Mars	1200000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.17	Automjet i mbyllur- kombe me pompë për lirim të kanalizimit fekal	Mars	1000000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.18	Pjesë të ujës-jellësit	Mars	11000000	Procedurë e hapur
1.19	Makina të vogla të ndryshme: agregatë, barë-kositëse, mjete të ndryshme dore dhe të tjera.	Mars	1500000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.20	Eskavator (i përdorur)	Mars	3000000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.21	HTZ pajisje	Maj	2000000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.22	Riparimi dhe kalibrimi i ujëmatësve	Qershor	920000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.23	IT pajisje (PC, Lap Top, server dhe printera)	Maj	2000000	Procedurë e hapur e thjeshtë

**N P për veprimtari komunale
"KOMUNALEC"-KËRÇOVË**

**Rruga Tranzite nr. 34, Tel: 071-221-505 Xhirollogaria - 200000003438739,
NVT. 4012989104619 e-mail: jpkomunaleckicevo@gmail.com:**

1.24	Kamion për mbledhje të mbeturinave komunale me shtesë prej 8-12 m ³	Maj	7500000	Procedurë e hapur
1.25	Automjet për mbledhjen e mbet.komunale 21m ³	Maj	9000000	Procedurë e hapur
1.26	pajisje diagnostikuese të automjeteve të pasagjerëve, pajisje diagnostikuese të automjeteve të lehta dhe të rënda	Maj	800000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.27	Dru për ngrohje	Qershor	700000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.28	Polimerë për Stacionin e filtrimit të uj.të zeza Kërçovë	Nëntor	2000000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.29	Fshesa kopshti	Qershor	150000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.30	Pjesë rezervë për automjete	Korrik	7500000	Procedurë e hapur
1.31	Vajra, yndyra, antifriz dhe mallra tjerë	Shtator	1200000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.32	Karburant për mjete lëvizëse	Shtator	7800000	Procedurë e hapur
1.33	Gypa betoni dhe konuse	Tetor	1500000	Procedurë e hapur e thjeshtë
1.34	Materiale ndërtimore	Tetor	6000000	Procedurë e hapur
1.35	Pjesë rezervë për St.filtrimit Kërçovë	Nëntor	3500000	Procedurë e hapur
1.36	Gypa për kanalizim dhe kapakë për shahta	Nëntor	300000	Furnizim i vogël
		Nëntor		Furnizim i vogël
		Gjithsej pa TVSH shuma e vlersuar e mallrave		99.500.000,00
2	II. Kontratë për furnizim publik të shërbimeve			
2.1	Shërbime hotelierike		600000	Furnizim i vogël- shpallje tjera
2.2	Rregullshmëria shëndetsore e ujit të pijshëm	Janar	1500000	Procedurë e hapur e thjeshtë
2.3	Transporti i mbeturinave	Janar	7000000	Procedurë e hapur
2.4	Regjistrimi i automjeteve dhe sigurim i detyrueshëm i automjeteve	Janar	300000	Furnizim i vogël
2.5	Procedurë për kadastrin nëntokësor	Mars	400000	Procedurë e hapur e thjeshtë
2.6	Angazhimi i shtëpisë projektuese për përpunimin e projekteve	Mars	2000000	Procedurë e hapur e thjeshtë
2.7	Mekanike, çelsbërës, Ngjitje e gomave, Reparim i turbinave, kontrollimi i diznave dhe takografi, Larje e automjeteve	Maj	1260000	Procedurë e hapur e thjeshtë
2.8	Kalibrimi i takografëve	Korrik	250000	Furnizim i vogël
2.9	Telefona celularë	Korrik	1000000	Procedurë e hapur e thjeshtë
2.10	Mirëmbajtje e harduerit dhe softuerit	Shtator	300000	Furnizim i vogël
2.11	Cilësia shëndetsore e ujit të pijshëm	Shtator	1200000	Procedurë e hapur e thjeshtë
2.12	Eskavator për deponi	Нември	1200000	Procedurë e hapur e thjeshtë
2.13	Revizion	Nëntor	120000	Мала набавка
2.14	Kontroll sanitar dhe sistematik I të punësuarve	Dhjetor	550000	Procedurë e hapur e thjeshtë
		Dhjetor		Procedurë e hapur e thjeshtë
		Gjithsej pa TVSH shuma e vlersuar e		17.680.000,00

		shërbimeve		
3	III. Kontrata dhe marrëveshje kornizë për furnizim publik të punësve			
3.1	Asfaltimi i gropave	Maj	2.100.000,00	Procedurë e hapur e thjeshtë
		Maj		Procedurë e hapur e thjeshtë
		Gjithsej pa TVSH shuma e vlersuar e punëve		2.100.000,00

REKAPITULIM

Gjithsej pa TVSH shuma e vlersuar e mallrave	99.500.000,00
Gjithsej pa TVSH shuma e vlersuar e shërbimeve	17.680.000,00
Gjithsej pa TVSH shuma e vlersuar e punëve	2.100.000,00
GJITHSEJ SHUMA E VLERSUAR pa TVSH në denarë	119.280.000,00

4.SEKTORI PËR PAGESËN E KËRKESAVE

Sektori i pagesave për kërkesat si sektor i veçant në vendosjen organizative të NP është formuar me Vendim të Këshillit Drejtues për plotësimin e Rregullores për sistematizimin dhe vlerësimin e punëve dhe detyrave të punës me nr.02-4306 prej më datë 31.12.2011.

Me Rregulloren e re për sistematizimin e vendeve të punës në NP "Komunalec"- Kërçovë numër 01-831/2 prej më datë 25.04.2018 është miratuar edhe Vendim nga Këshilli drejtues nr.02-919/5 prej më datë 10.05.2018, Sektori për pagesën e kërkesave e ka këtë vendosje organizatve:

Shifra	Vendi i Punës	Nr. i punëtorëve
KDR 01 02 B02 040	Udhëheqës i sektorit (pagesa e kërkesave) shitje dhe marketing	/
KDR 01 02 B04 033	Udhëheqës i njësisë për vërtetimin dhe pagesa	1
KDR 01 02 V02 041	Bashkëpunëtor i lartë për marketing	/
KDR 01 02 V01 100	Këshilltar për marrëdhënie me shfrytëzuesit	1
KDR 01 02 G04 035	Referent më i ri për kyçje të kontratave	1
KDR 01 02 G04 021	Referent më i ri regjistruar i të dhënave	1
KDR 01 02 G02 023	Referent i lartë- kontrollor i inkasantëve	1
KDR 03 05 B02 075	Referent- Inkasantë	20
KDR 01 02 G02 020	Referent i lartë për evidencën amë të personave juridik	1
KDR 01 02 G02 021	Referent i lartë për evidencën amë të personave fizik	1
KDR 01 02 B04 004	Udhëheqës i njësisë për kontrollë teknik të terrenit dhe shkyçjeve	/
KDR 03 05 B02 018	Shkyçës i shfrytëzuesve nga rrjeti i ujësjellësit	/
KDR 03 05 B04 053	KL Hidraulik	/
	Gjithsej:	27

1. Detyrat e punës të Sektorit

- Lidhja e kontratave për furnizim me ujë dhe faturim të ujit të shpenzuar – lexim i rregullt i ujëmatësve të gjithë personave fizikë dhe juridikë
- Dorëzim mujor dhe pagesë të llogarive për ujë të shpenzuar nga shfrytëzues persona juridikë dhe fizikë;
- Pagesë të llogarive për të gjithë muajt, pagesë pas padive, pagesë pas kontratave të lidhura, pagesë për çkyçje dhe kyçje të shfrytëzuesve nga rrjeti dhe pagesë pas bazave tjera
- Kontrolla të rregullta dhe të jashtëzakonshme (në pajtim me ankesat e shfrytëzuesve)
- kryen çkyçje të paguesve jo të rregullt dhe shfrytëzuesve ilegal nga sistemi i furnizimit me ujë si dhe të personave që kryejnë vjedhje nga sistemi i furnizimit me ujë

- Përgatit llogari të jashtëzakonshme, leje kontabile dhe raporte mujore për urdhëresat e realizuara
- Evidenton shfrytëzues të rinjë të shërbimeve dhe sipas nevojës kryen ndryshim të shfrytëzuesve në evidencën amzë
- I ndërmer të gjithë masat e nevojshme për pagesë të llogarive për ujë nga personat juridikë dhe fizikë
- Dërgon vërejtje për pagesë të vonuar deri te shfrytëzuesit
- Vërejtje për personat që llogariten si pasiv
- Vërejtje për shfrytëzuesit që nuk mundësojnë kushte për lexim të rregullt të ujëmatësit
- Jep propozime për paditje të paguesve jo të rregulltë të llogarive – faturave

2. Qëllimet

Spektori i Pagës për vitin rrjedhës 2022 do ti kushtoj kujdes të madh qëllimeve vijuese të vendosura:

- Evidentimi i të gjithë shfrytëzuesve që shfrytëzojnë shërbimi bartja e ujërave të zeza dhe vendosja e grafës pastrimi i ujërave të zeza me qëllim pagesa e shërbimit të ri
- Futja në sistemin e pagesave të shfrytëzuesve të shërbimeve komunale tek të cilat nuk është evidentuar dhe nuk kanë të lidhur kontratë për të njejtat (ndërtesa të reja, shtëpi të reja, ndryshimi i pronarëve etj)
- Rregullimi i çështjeve për shfrytëzuesit që janë trashëgimtarë të objekteve që mbahen në emrin e tjetër personi dhe jo në emrin e shfrytëzuesit të shërbimeve komunale
- Rregullimi i çështjes së shfrytëzuesve pa ujëmatës dhe të zbulojë lidhjet e paligjshme të ujit dhe kanalizimit
- Vendosja e sistemit për lexim të ujëmatësve në distancë (elektronik), si dhe futja dhe aplikimi i metodave të tjera moderne në punë
- Vendosja e sistemit për printim dhe dorëzim elektronik i faturave
- Vendosja e sistemit për lexim dhe evidentim më të sotisfikuar të ujëmatësve me fotografim dhe ruajtje të së njejtit dhe leximi në arkiv elektronike të veçant
- Vendosja e sistemit për evidencë të librave për lexim elektronik dhe bartja e të dhënave në bazë.

Një nga objektivat kryesore për vitin 2022 është rregullimi i rasteve tek shfrytëzuesit që përdorin ujë të pijshëm u paguhet mesatarisht përshkak të mungesës së ujëmatësve ose të njejtit janë të dëmtuar, si dhe të zbuloj shfrytëzuesit ilegal të shërbimeve komunale.

Nga ky aktivitet ne presim më shumë efekte pozitive si : reduktimi i humbjeve teknike dhe ekonomike, si dhe me atë zmadhimin e përqindjes së pagesës.

- Monitorim permanent i gjendjes faktive dhe kontabilitetit tek secili shfrytëzues i shërbimeve komunale
- Vëmendje e veçant do ti kushtohet zgjidhjes së rasteve tek shfrytëzuesit (personat juridik) që përdorin linjën shtëpiake në hapësira afariste.

Në vitin 2022 do të rriten kontrollat e kontabilitetit dhe të terrenit nga ana e punëtorëve në sektor (komisionet kohore, kontrollorëve dhe inkasantëve) si dhe punë e kordinuar e pagesave për vitin 2022, dhe presim që të ketë rritje të konsiderueshme për dallim me pagesat si në vitet e mëparshme.

- Aktivitete marketingut

Rritja e vetëdijes personale dhe kolektive të qytetarëve për shfrytëzimin e ujit të pijshëm dhe menaxhimi me mbeturinat, si dhe pagesa e faturave për shërbimet në nivel të shfrytëzuesve, përmes organizimit të

- Fushatës mediatike (radio, internet dhe materialet e shtypura) dhe
- Takime me qytetarët
- Vendosja e një shpërblimi bonus për shfrytëzuesit e rregullt në aspektin kryerje falas të shërbimeve të njëkohshme (ndërrim i ujëmatësit, ndërrim i ventililit, pastrim i pjesës private të kanalizimit dhe defekte tjera të vogla)

Sektori i pagesës për vitin planifikues 2022 do të marrë pjesmarrje aktive në projektet dhe aktivitetet vijuese

- „Menaxhimi me ujëmatësit e shfrytëzuesve“ në pjesën e leximit në distancë të ujit të shpenzuar dhe menaxhimit në distancë të ventilave

Ky është projekt me vlerë të madhe jo vetëm për Sektorin e Pagesës por edhe tërë ndërmarrjen sepse rezultati nga ky projekt është fitimi i të dhënave në kohë dhe të sakta nga shërbimet e kryera me të cilat procesi i pagesave fiton në cilësi, ndërsa me atë edhe më të rëndësishmen përqindje të zmadhuar të pagesës. Ky pilot projekt gjatë viteve 2017 dhe 2018 i dha rezultatet e saj dhe përshkak të këtyre rezultateve planifikojmë edhe gjatë vitit 2022 të furnizohen edhe 300 ujëmatës të klasës së lartë dhe 300 ventila me pajisjen e nevojshme të informatikës dhe automatike, me mundësi për rritje të numrit të tyre nëse lejojnë kushtet financiare.

Me këtë projekt dhe prioritetet e theksuara më lartë do të thotë se procesi i modernizimit dhe përsosshmërisë së Sektorit për pagesa vazhdon edhe më tutje, duke i ndjekur vijimet dhe trendet e reja në sferën komunale.

- Përgatitja e Sistemit Informativ Gjeografik në pjesën e Gjeopozicionimit të objekteve nga rrjeti i furnizimit me ujë: puseta të furnizimit me ujë, ventila, pompa dhe instrumente matëse (ujëmatës)

Sektori i Pagesave do të marrë pjesë aktive në gjeopozicionimin e lidhjeve të shfrytëzuesve me çka do të mundësohet evidentimi i numrit të saktë të shfrytëzuesve që përdorin instrumente ujëmatëse, shfrytëzues që nuk përdorin instrumente ujëmatëse dhe zbulimin e shfrytëzuesve që nuk janë të evidentuar në evidencën ekzistuese të ndërmarrjes.

Në vitin 2022 planifikohet përmirësimi i zgjidhjeve softuerike të programit kompjuterik, si dhe pajisjeve teknike me automjete dhe pajisje të nevojshme dhe materiale të punëtorëve të obliguar për ndërprerjen e shërbimeve për shkak të mospagesës.

Deri në fundin e vitit 2022 Sektori do ta realizoj detyrimin ligjor që në mënyrë elektronike ti dorëzojë llogaritë për shërbime komunale përmes rrugës elektronike për personat juridikë, me çka do të zvoglohen shpenzimet për dorëzim.

Rezultatet për punën e Sektorit me tregues financiar do të jenë të dhënë në raportin për çështje financiare të NP për vitin 2022.

5.SEKTORI PËR TEKNOLOGJI INFORMATIKE DHE ZHVILLIM

Sektori për teknologji informatike dhe projekte zhvillimore merrë pjesë në realizim të programëve zhvillimore në të gjithë njësitë punuese në kornizat e Ndërmarrjes publike për veprimtari komunale "Komunalec"- Kërçovë. Sektori për vitin e ardhshëm do të propozoj në drejtimet vijuese të veprimit:

- 1.1. Përpunim i Sistemit Gjeografik Informativ;
- 1.2. Përpunimi i projekteve për Monitoring dhe drejtimin e sistemit distributiv
- 1.3. Realizim i projektit "Udhëheqje me ujëmatës të shfrytëzuesve"
- 1.4. Pjesëmarrje në projekte që janë të parapara në programin e Ministrisë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë me qëllim për mbështetjen e punës së ndërmarrjes
- 1.5. Përmbushja e kriterëve të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale
- 1.6. Trajnim për përcjellje të trendeve në teknologjin e informatikës dhe zhvillim të patjetërsueshëm për realizim të qëllimeve të parapara

1.1 Përpunim i Sistemit Gjeografik Informativ

Çdo planifikim fillon me planifikimin e hapësirës, nga aty, është e logjikshme planifikimi i politikave zhvillimore të ndërmarrjes të fillojnë nga planifikimi i hapësirës të veprimtarisë së vete. Për atë është e nevojshme të organizohet hartimi i sistemit informatik gjeografik dhe do të organizojë të gjitha hartimet e nevojshme të objekteve të infrastrukturës që janë brenda kompetencës së ndërmarrjes për të regjistruar dhe monitoruar parametrat bazë të nevojshëm për analizë.

1.1.1. Hartimi i rrjetit të shpërndarjes dhe objekteve të tij: pusetave të ujësjellësit, ventilave, pompave dhe instrumenteve matëse (ujëmatës) dhe një përshkrim të hollësishëm të tyre

1.1.2. Hartimi i rrjetit të kanalizimit dhe objekteve të tij dhe një përshkrim të detajuar të të njëjtit

Për këtë aktivitet do të përdoren hartat e përgatitura për nevojat e projektit "Reforma e sistemit për furnizimin me ujë, grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza në nivel lokal, financiar nga" Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor ".

Që të realizohen aktivitetet e shënuara paraprakisht është e nevojshme të sigurohet hardver adekuat dhe softver operativ për përpunim kompjuterik instalim dhe distribuim të aplikacioneve shfrytëzuese deri te Njësit punues dhe Sektorët e ndërmarrjes. Është e nevojshme të organizohet një tender për caktimin e përgjegjësisë për një kompani të autorizuar për regjistrimin e infrastrukturës së menaxhuar nga ndërmarrja.

1.2 Monitoring i sistemit distributiv

Sektori për vitin e ardhshëm planifikon të organizoj aktivitetet që do të rezultojn me përpunimin e projektit dhe fazën implementuese të sistemit SCADA, model Dixhital për Monitoringun e sistemit distributiv. Ky model siguron informata vitale për rregullimin e rezhimit të punës të sistemit distributiv dhe zakonisht përbëhet prej:

1. Monitoringut dhe drejtimit të zakonshëm dhe rrjedhjes
2. Monitoringu i parametrave për kualitetin e ujit
3. Azhurimi, kalibrimi dhe shfrytëzimi i një modeli të simulimit hidraulik të ndërtuar gjatë drejtimit operativ
4. Përpunimi i procedurave rutinore operative dhe procedurave standarde operative

1.3 Udhëheqje me ujëmatësit shfrytëzues

Qëllimi kryesorë i këtijë projekti është të zhvillohet Model i integruar për ughëheqje me ujëmatësit për minimizim të humbjeve të ujit gjatë matjes dhe maksimizim i të ardhurave nga uji i distribuar.

Si rezultat i këtijë projekti është paraparë të hartohet:

1. Zgjerimi i zonës pilot të instalimit të ujëmatësve me lexim dhe kontroll të largët
2. Vendosja e matësve të ujit të papërpunuar për lidhjet në blloqet rezidenciale Aktivitetet afatshkurtra
3. Rregullore për përllogaritje të humbjeve të ujit në bazë të saktësisë teknike të ujëmatësit.
4. Rregullore për përcaktimin e ujëmatësve më të mirë në varësi të specifikave të rrjetit
5. Rregullore dhe mjete për frekuentim të ndryshimeve të ujëmatësve

1.4 Menaxhimi i ujit të Papërshtatshëm

1. Iniciativa për Formimin e njësis organizative për menaxhimin me ujin e papërshtatshëm
2. Fillimi me matjen më precize dhe evidentimin , shfrytëzimin e modeleve hidraulike
3. Përmisimi dhe azhurimi i bilansit të ujit në bazë të të dhënave dhe matjeve më të sigurta
4. Furnizimi me telefon matës dixhital për rrjedhjen dhe shtypjen
5. Trajnim për Shfrytëzimin e pajisjeve për detektim të rrjedhjeve dhe angazhimi i një kompanie të specializuar për të kryer kontrollin

1.5 Pjesmarrja në projekte që janë të parapara në programin e Ministrisë së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me qëllim për mbështetjen e punës së ndërmarrjes

Pjesmarrja në projektet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë që janë të parapara për implementimin në përputhje me projektet

- 1. Përmirësimi i mbledhjes së ujërave të zeza dhe infrastrukturës për trajnimin e ujërave të zeza në Komunën e Kërçovës "
- 2. Përgatitja e dokumentacionit të projektit për përmirësimin e infrastrukturës së grumbullimit të ujërave të ndotura në Komunën e Kërçovës "
- 3. Reforma e sistemit të furnizimit me ujë, mbledhjes dhe trajtimit në nivelin lokal
- 4. Zhvillimi i një studimi kombëtar të ujit

Identifikimi, përgatitja dhe monitorimi i programeve, planeve dhe aplikimeve të projektit duke përgatitur detyra projekti, në përputhje me përparësitë strategjike dhe programin e biznesit të ndërmarrjes, programet e donatorëve dhe burimet e tjera të financimit,

- Formimi dhe përditësimi i rregullt i bazës së të dhënave të projektit.
- Përgatitja e analizës ekonomike për arsyetimin e projektit
- Përgatitja e analizës financiare për arsyetimin e projektit

Analiza e efektivitetit dhe efikasitetit i zgjidhjeve të reja, monitorimi i procesit të projekteve me interes në fushën e ndërmarrjes mbi bazën e treguesve të përcaktuara;

1.6 Përmbushja e kriterëve të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale

Për të përmbushur kërkesat e parashikuara nga "Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale" sektori do të ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme:

1.6.1 Zhvillimi dhe praktikimi i procedurave të parashikuara me ligj dhe rregullore

1.6.2 Ridizajnimi dhe përditësimi i aplikacionit kompjuterik për shërbime komunale me qëllim përmbushja e kërkesës në bazë të ligjit.

1.7 Trajnim për ndjekje të trendeve në teknologjinë e informatikës dhe zhvillim të patjetërsueshëm për realizim të qëllimeve të parapara

Të punësuarit të cilët do të udhëheqin me këtë pajisje dhe teknologjinë informatike, patjetër është edukim në kontunitet me ndjekje të kurseve oficiale të prodhuesve të paisjeve, teknologji të cilat nuk janë të parapara me sistemin arsimorë oficial shtetërorë dhe edukim për udhëheqje dhe shfrytëzim të aplikacioneve të parapara të shfrytëzuesve.

Për ndjekje të sukseshme të trendeve të reformave intenzive në Shtet është e patjetërsueshme udhëheqësit e ndërmarrjes të miratojnë dhe ndjekin teknologjitë e reja për udhëheqje efektive dhe efikase, që e paraqet nevoja për organizim të kurseve edukative nga lëmit përkatëse.

6. SEKTORI UJËSJELLËSI, KANALIZIMI DHE NDËRTIMI

Sektori Ujësjellësi, kanalizimi dhe ndërtimi i kryen veprimtaritë e tyre përmes:

- Njësia ujësjellësi dhe kontrolli sanitar i ujit të pijshëm**
- Njësia për mirëmbajtjen e ujësjellësit- Kërçovë**
- Njësia për mirëmbajtjen e ujësjellësit- Zajaz**
- Njësia për mirëmbajtjen e ujësjellësit- Oslome**
- Njësia për ndërtimin dhe bartjen e ujërave të zeza urbane**
- Njësia për pastrimin e ujërave të zeza urbane dhe**
- Njësia për ndërtim**

Kujdeset për rregullshmëri të vazhdueshme të ujësjellësit, montimet e ujësjellësit dhe kanalizimit nëpër objekte, ndërmerr masa të rregullta për mirëmbajtje të tyre dhe riparim, rregullisht dhe në kohë

informim për gjendjen dhe defektet e objekteve dhe instalimeve nëpërmjet mjeteve për informim publik.

Në periudhën planore Ndërmarrja në lëmin e ujësjellsit dhe kanalizimit planifikon bashkëpunim operativ dhe administrativ më të madh dhe pjesmarrje në hartimin e kadastrës digjitale nëntokësore të rrjetit me që do të rriten aktivitetet në kualitet dhe kuantitet dhe me atë edhe kualiteti i shërbimit të Ndërmarrjes ndaj qytetarve.

Njësia ujësjellësi dhe kontrolli sanitar i ujit të pijshëm

Kontrolli sanitarë dhe mirëmbajtja e ujit të pijshëm në rregullshmëri të plotë, bëhet vazhdimisht, me klorim permanent i të njejtës dhe me dërgim të rregullt të ekzemplarve të ujit të marrë nga lokacione të ndryshme nga sistemi i ujësjellsit-në analizë në institucionet relevante në institucionin në Manastirë.

Njësia për ndërtim dhe mirëmbajtje të instalimeve të ujësjellsit dhe kanalizimit

Rrjeti distributiv i ujësjellsit në pjesën më të madhe është ndërtuar para 50 vitesh, ka prezencë të azbesit në gypat prej betoni të cilat nga shqyrtimi sanitarik dhe teknik tashë më janë kaluar. Në pjesën më të madhe nga rrjeti i ujësjellsit ka diametra të vogël në gypat të cilat realisht nuk mund të përgjigjen kërkesave të ditës së sotme për ujë. Ndarja në rrjetin distributiv është arsyeja për shtypje të lartë por edhe shumë të ulët në punë. Në kushte të shfrytëzimit maksimal të ujit, disa lagje, nuk mund në mënyrë kualitative të furnizohen me ujë që është tregues se ekzistojnë të ashtuquajturat „gypa të ngushtë“, në sistem.

Këto janë disa çështje të rëndësishme që janë të pranishme në sistemin e furnizimit me ujë për të cilën Ndërmarrja ndërmerr masa për zgjidhjen e tyre. Duke patur parasysh fuqinë financiare në periudhën planifikuese, Ndërmarrja për Ujin planifikon të ndërtojë më shumë linja të përcjelljes së ujit, me qëllim përmirësimin e furnizimit me ujë, por këto aktivitetet nuk i kënaqin nevojat për rikonstruimin e sistemit të furnizimit me ujë, prandaj Ndërmarrja në bashkëpunim me Komunën e Kërçovës ndërmerr masa për mbledhjen e mjeteve financiare për rikonstruimin më serioz të sistemit të furnizimit me ujë.

Aktivitetet e planifikuara për vitin e ardhshëm do të paraqiten përmes:

Rikonstruimi i furnizimit ekzistues me ujë dhe ndërtimi i linjave të reja të ujësjellsit.

Mirëmbajtja aktuale e sistemit të furnizimit me ujë

- Mirëmbajtja preventive e rrjetit dhe lidhjeve kryesore;
- Mirëmbajtje parandaluese; (Zëvendësimi i pajisjeve dhe pastrimi), vendosja e kapësve për papastërti për linja të ujësjelljes me diametër prej 50mm-160mm;
- Menaxhimi me pjesën e pjesëve rezervë;

Rikonstruimi i furnizimit ekzistues me ujë dhe ndërtimi i linjave të reja të ujësjellësit

Si aktivitete prioritare në rikonstruimin dhe zgjerimin e sistemit të furnizimit me ujë llogariten ato që do të japin efekte më të mëdha në sigurimin e furnizimit më cilësor me ujë dhe që do të sigurojnë zvoglim më të madh të humbjeve të ujit. Në vitin 2022 poashtu parashihet rikonstruimi i Rezervoarit kryesor të ujit në qytetin e Kërçovës

Tabela: Rikonstruimi i paraparë me mjetet e veta të ndërmarrjes në qytet

Nr.re.	Lokacioni	Materiali egzistues	Diametri egzistues [Φ]	Material i propozuar	Diametër i propozuar [ND]	Gjatësia (m)
1.	Rr. 4 Korriku-të përfundohen kycjet					
2.	Rr. Uzhiçka (prej tek rrethi në udhëkryqin në Rrugën Magjistrale nën stacionin hekurudhor)	azbest	250	PE	160	600
3.	rr."29 Nëntori"	Azbest, gus	80	PE	90	1000
4.	rr.Stojan Sandeski (nga rr.11-Shtatori deri në urën Çiflig)	metal	2"	PE	63	700
5.	rr.Marshall Tito (nga ndërtesa Rruga Maqedone deri rruga rajonale Kërçovë-M.Brod)	PE	110	PE	110	750
6.	rr.Marshall Tito (nga rr.Zagorje deri fsh.Mahmude)	PE	75	PE	110	1900
					Gjithsej	4.950m

Rrjeti i ujësjellësit në fsh. Zajaz:

Gjatë viteve të fundit janë të zgjeruara shumë lagje në fsh.Zajaz, edhe me atë nevojë për ndërtimin e linjave të reja. Në bazë të nevojave në teren duke patur parasysh problemet (defektet) e shpesh të cilat paraqiten në kontinuitet në rrjetin e ujësjellësit të Zajazit, janë të nevojshme punët në prioritet si në vijim:

1. Lista e punëve me prioritet të cilat duhet kryer në mënyrë sa më të shpejt:

- 1.Ndërrimi i trasës në Lagjen M.Re-Zajaz Teqe:
DN 63 = 750 M
- 2.Ndërrimi i trasës në Lagjen Llanaj- Zajaz Xhuma:
DN 63 = 70 M
- 3.Vazhdimi i trasës në Lagjen Pirkaj- Zajaz Teqe:
DN 63= 250 M
4. Ndërrimi i trasës në B.L Zajaz Teqe linja që furnizon B.L Kolibar:
DN 63 = 700 M
5. Ndërrimi i trasës në fsh.Kolibar: DN Φ 63=250 m
6. Ndërrimi i trasës në lagjen Pirkaj: DN Φ 63=130 m
7. Dislokimi i trasës në fsh. Drogomisht i Vogël: DN Φ 63=150 m

Gjithsej: 2250 metre

Njësia për mirëmbajtjen e ujësjellësit- Oslomej

Njësia për mirëmbajtjen e ujësjellësit- Oslomej për vitin 2022 parashikon rikonstruimin e rrjetit egzistues të ujësjellësit DN- Φ 75 në fsh. Strellcë- Garanë gjatë rrugës për në fsh.Shutovë me gjatësi prej 500 metre poashtu në lagjen Loshaj fsh.Garanë DN- Φ 75 gjatësi 150m, fsh.Garanë DN- Φ 90 gjatësi 300 metra.

Rikonstruimi i rregullatorëve për shtypje në fsh.Sërbicë dhe fsh.Garanë.

Pastrimi i rezervoarëve në fsh.Sërbicë, fsh.Garanë dhe fsh.Jagoll.

Është paraparë edhe ndërtimi i 2 stacioneve të klorit në rezervoarët egzistues në llokacione dhe vende të ndryshme, si dhe rikonstruimi i stacioneve të pompave për fshatrat Jagoll dhe Sërbicë.

Sistemi i ujësjellësit për Komunën e Kërçovës

Gjatë realizimit të aktiviteteve të parapara të rikonstruimit të pjesëve njësi të sistemit të ujësjellësit për Komunën e Kërçovës, nga ana e njësive tjera në NJP "Ujësjellësi", kanalizimi dhe realizimi, një pjesë nga njësia punuese do të jetë logjistike e përhershme ndërtimore në realizimin e objekteve të linjave të rikonstruara nga sistemi (puseta, ankerat etj.).

Rrjeti i kanalizimit fekal në Komunën e Kërçovës

Njësia për ndërtimin dhe bartjen e ujërave të zeza urbane Mirëmbajtje aktuale të bartjes së ujërave të zeza në Komunën e Kërçovës

Rrjeti i përgjithshëm i kanalizimit është afër 80 km dhe rrjeti përbëhet prej tubacioneve me diametra të ndryshme nga 150mm deri 600mm.

Me fazën e dytë të projektit për rikonstruimin e rrjetit të kanalizimit në Komunën e Kërçovës, është paraparë dhe rikonstruimi i të gjitha linjave problematike të kanalizimit, a NP "Komunalec"- Kërçovë do të kryej intervenim urgjent nëse për atë paraqitet nevoja.

Rrjeti egzistues i ndërtuar i kanalizimit fekal të cilën e mirëmban NP "Komunalec"- Kërçovë, mirëmbahet rregullisht dhe çdo ditë. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit në gjendje të mirë është kryer duke përdorur një presion tank dhe ndërhyrje me mjete dore (sajlla, shtylla, çakle etj.) Përveç kësaj kryen rregullisht:

- Hapja e pusetave nga toka ose asfalti;
- Nivelizimi i pusetave të larta dhe të ulta deri te lartësia normale drejt rrugës;
- Sanimi i pusetave ekzistuese në qytet etj.

Për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit paraqitet nevoja për cisternë dhe kombe për lirim të gypave të kanalizimit. Sipas kësaj, me këtë program parashihet furnizimi i **cisternës dhe kombeve - për lirim të gypave në kanalizimin fekal.**

Qëllimi i programit për punë dhe zhvillim të seksionit është që të mënjanohen anomalitë e sistemit të kanalizimit dhe të zvoglohen problemet që paraqiten në të njëjtin sistem. Për realizimin e këtij qëllimi janë të nevojshëm hapat vijues:

- Pastrimi i rregullt i kanaleve larguese të kanalizimit fekal;
- Pastrimi çdo ditë i mbeturinave në puseta;
- Kontrolli i rregullt, evidentimi dhe mirëmbajtja e pikave kritike në territorin e Komunës së Kërçovës;
- Në kushte të sasive të rritura të reshjeve do të veprohet në mënyrë preventive, me kontroll dhe pastrim të pusetave në pikat kritike, kontroll dhe intervencë sipas nevojës të kanaleve kritike;
- Pastrim i rregullt i vendit të mbeturinave që gjendet mbi stacionin e benzinës "Power Petrol"

- Mënjanimi i krerëve të ngushta në sistemin e kanalizimit fekal në bashkëpunim me seksionin për realizim;
- Nivelizimi i pusetave të kanalizimit në rrugët ku është kryer asfaltimi;
- Tërësisht do të ndërrohet ose do të sanohet pjesa e kapaqeve të pusetave të kanalizimit, të zvoglohet hyrja e rërës dhe mbeturinave që shkaktojnë probleme në mirëmbajtjen aktuale.

Mirëmbajtja e përditshme

Mirëmbajtje e rregullt e objekteve në sistemit e furnizimit me ujë dhe rrjetit të kanalizimit fekal në Komunën e Kërçovës (puseta, kapakë dhe të tjera)

Njësia për pastrimin e ujërave të zeza urbane

Njësia për pastrimin e ujërave të zeza është e organizuar në këtë mënyrë:

Vende Pune	Numri i realizuesve
Udhëheqës i njësisë për pastrimin e ujërave të zeza urbane	1
Ndihmës udhëheqës i stacionit të pastrimit	1
Inxhinjer kryesor për mirëmbajtje elektronike dhe makinerike	1
Laborant për analizë kimike dhe bakteriologjike e ujit	2
Teknik për mirëmbajtje elektro-makinerike	1
Teknik sanitar	1
Mirëmbajtës i stacionit të pastrimit së ujërave të zeza	3

Në njësinë e Stacionit të pastrimit kryhen këto punë:

Stacioni i pastrimit të ujërave të zeza ka për qëllim që ti pranojë ujërat e zeza të qytetit të Kërçovës përmes sistemit të kolektorit që drejtohet në hyrje të stacionit, të kryej trajtimin adekuat të tyre dhe si të trajtuara ujërat e zeza si të pastruara ti lëshojë në lumin e Zajazit. SPUZ (Stacioni Pastrimit të Ujërave të Zeza) aktivitetet e saj i kryen në përputhje me procesin e paraparë teknologjik dhe në përputhje me Programin vjetor për punë dhe zhvillim të investimeve investuese në Ndërmarrje. Procesi Teknologjik i SPUZ është ndarë në disa segmente, të ndërlidhura dhe të ndërvarura.

o Trajtimi mekanik i ujërave t zeza

- Impianti i pompës hyrëse për marrjen e ujërave të zeza nga sistemi kryesor grumbullues i qytetit të Kërçovës dhe drejtimin e tyre në grilat mekanike

- Rrjeta mekanikisht të imta për ndarjen e ndotësve të ngurtë dhe të trashë të pranishëm në ujërat e zeza

-mbajtës rëre për heqjen e rërës dhe yndyrës së pranishme në ujërat e zeza (funksionon me ajrim të vazhdueshëm për pompimin më të lehtë të rërës aktuale dhe ndarjen e saj përmes një ndarësi rëre, dhe yndyra drejtohet në një ndarës yndyrash. Njësia rëra dhe yndyra hudhen në kontejnera dhe deponohen në deponi adekuate).

- sedimentet parësore ku depozitohet në mënyrë gravitacionale "llumi".

○ **Trajtimi biologjik i ujërave të zeza**

- reaktor biologjik (pishinë-për llumin e aktivizuar). Këtu bëhet trajtimi biologjik i ujërave të zeza nga sedimentet parësore, përkatësisht zbërthimi biologjik bëhet në një mjedis aerobik (ekziston një masë biologjike-baktere dhe mikroorganizma që në prani të oksigjenit të tretur zbërthejnë masën organike dhe formojnë "llum aktiv". ") funksionimi i qetë i bioreaktorit ajroset vazhdimisht

- sedimentet dytësore: sedimentet ku "llumi" depozitohet në mënyrë gravitacionale, tashmë bëhet fjalë për llum sekondar (llum aktiv tashmë i trajtuar biologjikisht - sedimentimi përfundimtar për ndarjen e llumit aktiv nga ujërat e zeza) nga sedimentet dytësore, ujërat e zeza tashmë të trajtuara si të pastra dërgohen tek lumi i qytetit (që plotëson plotësisht justifikimin për ekzistencën e SPUZ) llumrave dytësore aktuale të depozituara gravitacionale në sedimentet dytësore mund të ndahen në:

- llumi i aktivizuar riqarkullues (RAS) çohet në reaktorin biologjik për të ruajtur nivelin e kërkuar të biomasës dhe një pjesë drejtohet
- llumi i tepërt i aktivizuar (SAS) i cili dërgohet:
 - 1) tek impianti ku kryhet "tharja" e saj përkatësisht trajtohen në centrifugë në prezencë të polimerëve si dhe pasi "i dehidratuar" hidhet në fusha të thata (këtu me anë të kullimit dehidrohet dhe është gati si mbetje teknologjike për t'u hedhur siç duhet në një landfill për këtë qëllim ose
 - 2) në segmentin e SPUZ ku do të jetë e trajtuar kimikisht

Aktivitete që kryhen në njësinë e SPUZ

Stafi që shërben dhe kujdeset për mbarëvajtjen e funksionimit të SPUZ ndahet gjithashtu në disa grupe:

○ **Laborator**

Laboratori i SPUZ teston në mënyrë të vazhdueshme ujërat e zeza që hyjnë në impiantin e trajtimit (merr mostra dhe monitoron parametrat që ndikojnë në procesin teknologjik) dhe teston ujin që pas trajtimit ashtu siç shkarkohet derdhet në lumin e qytetit (uji që derdhet në një lumë të qytetit duhet plotësojnë parametrat e parashikuar në rregullativat ligjore të Ministrisë së Mjedisit Jetësor).

○ **Grupi teknologjik**

Këtu zhvillohen të gjitha fazat e trajtimit të ujërave të zeza dhe ndjekin procesin teknologjik, jepen drejtimet për udhëheqjen e procesit, bëhen regjistrime të plota të parametrave të procesit teknologjik.

○ **Grupi teknik**

Këtu procesi teknologjik monitorohet përmes sistemit të mbikëqyrjes dhe menaxhimit SCADA, ata sugjerojnë menjëherë çdo ndryshim në proces dhe ua komunikojnë punonjësve të grupit të teknologjisë. Të gjitha pajisjet mekanike dhe elektrike të instaluar në SPUZ mbikëqyren dhe mirëmbahen (në varësi të problemit e zgjidhin vetë ose sugjerojnë nevojën për shërbimin e tij).

○ **Operatorë**

Kryhet mbikëqyrje e vazhdueshme e punës së mjeteve në SPUZ:

-pastrimi i pajisjeve dhe objekteve

-largimi i mbetjeve të ngurta të ndara dhe rërës

-largimi i mbetjeve teknologjike të fituara nga llumi i trajtuar në centrifugë dhe asgjësimin e saj në fusha të thata

7. SEKTORI HIGJIENA KOMUNALE

Aktivitetet kryhen përmes tre njësive.

1.Njësia për mbledhje, transport dhe deponim të mbeturinave komunale

2.Njësia për parqet dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike qarkulluese

3.Njësia për menaxhim me varrezat

Programi nënkupton grumbullim të organizuar dhe transport të mbeturinave komunale në një mjedis urban i cili është në pajtim me rregullat ligjore e që ka ndikim direkt në mbrojtjen e mjedisit jetësorë. Në program janë të përfshirë të gjithë zonat e populluara që gjenden në territorin e Komunës së

Kërçovës. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave komunale kryhet me anë të automjeteve të specializuara për atë punë. Dinamika e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale në territorin e komunës është e mvarur nga:

- Dendësia e popullsisë
- Sasia dhe struktura e mbeturinave komunale
- Shoqëritë, kulturat dhe te tjerat aftësi dhe shprehi të qytetarëve
- Kushtet e trafikut
- Lloji dhe numri shportave për mbeturinat komunale

Për funksionim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale, territori i komunës i cili bën pjesë në planin e përgjithshëm urban , i ndarë në rajone nga i cili grumbullohen në ndërkohë mbeturinat e hudhura nga ana e personave fizik dhe juridik edhe për këtë duhet angazhuar çdo ditë një numër i konsiderueshëm i automjeteve për mbledhjen e tërsishme të mbeturinave komunale sipas dinamikës së paraparë.

Për shkak të situatës së sapo krijuar me virusin Kovid-19, Ndërmarrja publike Komunalec-Kërçovë kryen çdo ditë spërkatje të rrugëve me hipoklorit natriumi me cisternë prej 8m3. Shpenzimet rreth kësaj situatë të sapo krijuar biejnë në barrë të NP "Komunalec"- Kërçovë, me të cilën ndërmarrja është ngarkuar me shpenzime shtesë.

Gjendja momentale me menaxhimin me mbeturinat komunale në Komunën e Kërçovës është e rëndë për arsye se mbeturinat çdo ditë dërgohen në fsh.Novaci- Komuna e Manastirit dhe në M.Brod në deponinë Barbaras, përshkak se NP "Komunalec"- Kërçovë nuk mund me kohë të transportojë mbeturinat e mbledhura, edhe pse nëpër rajone mbledhen rregullisht. Kjo dmth se i të gjitha mbeturinat në rajone të caktuara i mbledhim rregullisht, por jemi të detyruar ti rimarrim ato përshkak se pjesë e automjeteve nuk janë në gjendje të shkojnë për në Manastirë por disa nga ato kanë edhe nga dy turne, kështu që NP me rimbushje nga një vend i caktuar e dërgon në Manastirë ku ndjeshëm rriten harxhimet për karburantë dhe amortizim të NP "Komunalec"- Kërçovë. Poashtu duhet të përmendim se mbledhja e mbeturinave komunale në Komunën e Kërçovë është zgjeruar në vitin 2019 edhe atë nëpër disa fshatra Kolibar, Sërbicë, Arangjell dhe Trapçin Doll, gjë që e komplikon edhe më shumë punën tonë me transportin e mbeturinave në deponin në fsh.Novaci por por me gjithë përpjekjet ne jemi të detyruar të bashkëpunojmë me palë të treta për të cilët paguajmë shuma të mëdha parash. Përveç së lartë përmendurës, NP Komunalec detyrohet të blejë automjete të reja për të përmbushur grumbullimin dhe transportin e mbeturinave në një deponi që është të paktën larg 200 km (në të dy drejtimet).

Prodhimi i mbeturinave të ngurta supozohet të rritet si me numrin e banorëve ashtu edhe të amvisërive, si dhe me trendin e paketimit dhe brendit të produktit.

Ndërmarrja në bashkëpunim me Komunën e Kërçovës ka përgatitur një studim fizibiliteti dhe një projekt për blerjen e dy automjeteve speciale për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave komunale. Ky projekt është financuar nga Komuna e Kërçovës dhe është financuar pjesërisht nga një kredi e Bankës Botërore.

Në vitin 2022 planifikojmë marrjen e automjeteve të reja, e cila është pikë fillimi për përmirësim të shërbimit komunal "grumbullimi dhe transporti i mbeturinave komunale" e cila duhet të mbështetet me ndryshime të thella në qasjen e përgjithshme të punës në njësinë punëtore Higjena e Komunës dhe sektoreve për mbështetje të ndërmarrjes.

Me marrjen e automjeteve të reja planifikojmë të arrijmë:

- Rritja e efektit dhe efikasitetit dhe mirëmbajtjen e shërbimit dhe transportin e mbeturinave të forta të mbeturinave komunale
- Dinamika e rregullt e shërbimeve në pjesët urbane dhe rurale me angazhim minimal të automjeteve dhe hapësire të mjaftueshme për mirëmbajtje të rregullt.
- Riorganizim i mënyrës konvencionale për grumbullim të mbeturinave komunale dhe intervenim intenziv i selektimit grumbullues.
- Rritja e përqindjes së pagesës
- Organizim më i mirë për mbledhjen e mbeturinave
- Përmisimi i shërbimit do të ketë ndikim pozitiv në imazhin e ndërmarrjes dhe komunës, qytetarët dhe shërbimet kompetente.

Mënyra konvencionale e udhëheqjes me mbeturinat krijon një varg problemesh nga aspekti ekologjik, ekonomik, sigurimi shëndetsorë, estetik me të cilën shkelen kushtet për jetesën dhe punën e qytetarëve të bashkësisë.

Të zvogëlohet dhe mënjanohet ndikimi i fort ekologjik që formohet nga mbetjet sekondare në territorin e Kërçovës dhe cilësitë shfrytëzuese të mbeturinave dhe kthimi e tyre në proces prodhues është qëllim të cilin planifikojmë ta realizojmë duke formuar struktura adekuate përkatëse të cilat do të promovojnë selektimin e mbeturinave komunale në nivelin krijues, garantojnë rregulisht dhe në mënyre të rregullt grumbullimin, magazinim dhe riciklim dhe në atë mënyrë të zvogëlojnë sasinë dhe volumin i cili deponohet në vend adekuat dhe të pa sigurt.

Vende Pune	Numri i realizuesve
Udhëheqës i Sektorit Higjiena komunale	/
Referent më i ri- Punëtor administrativ	1
Përgjegjës për sigurim dhe mbrojtje të personave	3
Higjienist	1

Udhëheqës i njësisë për mbledhjen, transportin dhe deponimin e mbeturinave	1
Menaxhues me mbeturinat	/
Punëtor për mbledhjen e mbeturinave	22
Punëtor për mbledhjen e mbeturinave të parrezikshme industriale	/
Punëtor për ballimin e mbetjeve sekondare	2
Roje-Punëtor në deponinë e mbeturinave komunale	/
Roje-Inkasant i deponisë së mbeturinave	/
Udhëheqës i njësisë për ngritjen e gjelbërimit	/
Inxhinier i Hortikulturës dhe mbrotjes së mjedisit jetësor	/
Drejtues i automjeteve bujqësore	3
Pastrues	19
Fshirës	4
Udhëheqës i varrezave	1
Inxhinier për infrastrukturën e varrezave të qytetit	/
Referent më ri kartotekar	1
Punëtor- Roje për mirëmbajtjen e varrezave	2
Shofer i automjeteve special	22
Gjithsej:	82 të punësuar

Nisja e këtij aktiviteti bazohet në përvojat aktuale duke vënë shporta metale për grumbullimin e plastikave . Eshtë evidente se qytetarët edhe pse jo në mënyre të plotë por me kontiunitet i përdorin këto ambalazha për plastikë. Si rezultat i kësaj Ndërmarrja e rriti numrin e këtyre ambalazhave të plastikës.

Në vitin 2022 planifikojmë akcion më intenziv dhe të planifikuar për selektimin, mbledhjen dhe uljen e vëllimit për mbeturinat komunale të selektuara.

Me implementimin e këtij projekti do të hapet proces për promovimin e sistemit të infrastrukturës që do të garantojë mbledhje dhe reciklim i rregullt i mbeturinave nga ambalazha, mundësi për zhvillim ekonomik dhe do të ndikojë në kualitetin e jetës në subjekte afariste si dhe në çdo qytetar veçmas:

Përveç mbledhjes në vazhdim të mbeturinave komunale është planifikuar:

-Kampanjë për rritjen e vetëdijësimit të qytetarëve kundrejt mjedisit jetësorë me theks të veçantë duke respektuar rregullat për grumbullimin e mbeturinave komunale.

-Inicijativë për rritjen e diciplinës së qytetarëve për respektimin e grumbullimit të mbeturinave të forta në bashkëpunim me inspektorët komunal pranë Komunës së Kërçovës, Kryetarit dhe Këshilit.

Pastërtia publike dhe gjelbërimi publik në vitin 2022 do të mirëmbahen rregullisht dhe në vazhdimësi ne bazë të programit për mirëmbajtje të Pastërtisë Publike. Në kompensimin e llogaritur në llogarinë për shërbime të rregullta komunale Ndërmarrja do të investoje në mjete të reja dhe mehanizëm me të cilën do të përmirësohet kualiteti i përfundimit të këtij shërbimi.

Menaxhimi me varrezat e qytetit do të bëhet rregullisht dhe në vazhdimësi ne vitin 2022. Poashtu varrezat e reja Krishtere do të rregullohen, dhe të ndërtohet në bazë të proektit ekzistues. Shërbime në masë të madhe do të mvaren nga implementimi i ligjit për varrezat dhe shërbime varrimi, sipas të cilit kryerja e aktiviteteve menaxhuese të varrezave është në kompetencë të NP KOMUNALEC – Kërçovë. E përfshirë është edhe tatim varrimi në pajtim me ligjin me të cilat mjete financiare do të behet mirëmbajtja e varrezave të vjetra dhe të reja të varrezave të qytetit.

Puna operative e Njesisë punuese është treguar në tabelat si në vijim

Dinamika e dorës punuese është e kryer në bazë të normave mesatare dhe përmes inçizimit të detyrave ditore të punës

SHQYRTIM I TONAZHIT TË PËRGJITHSHËM TË MBETURINAVE KOMUNALE

MBETURINA PËR vitin 2020 – 2021 në muaj krahasuar dhe 2022 planifikuar

MUAJ	ОТПАД тон/ден-2020	ОТПАД тон/месец.- 2020	ОТПАД тон/ден-- 2021	ОТПАД тон/месец- 2021	Планирано 2022отпад тон-ден	Планирано Отпад тон/месец- 2021
Janar	72	2232	75	2325	77	2310
Shkurt	70	2 030	73	2044	75	2250
Mars	71	2201	74	2294	76	2280
Prill	68	2040	71	2130	73	2190
Maj	72	2232	75	2325	77	2310
Qershor	74	2220	77	2310	79	2370
Korrik	84	2604	87	2697	89	2670
Gusht	90	2790	93	2883	95	2850
Shtator	83	2490	86	2580	88	2640
Tetor	81	2511	84	2604	86	2580
Nëntor	75	2250	78	2340	80	2400
Деември	71	2201	74	2294	76	2280
вкупно	911	27801	947	28826	971	29130

NJËSIA VARREZAT E QYTETIT

Në Komunën e Kërçovës ekzistojnë dy lokacione që paraqesin varreza të qytetit dhe atë: Varrezat e vjetra të qytetit që janë me sipërfaqe prej rreth 7000 m2 dhe janë të vendosura mes rrugëve "Rudnička" dhe "Mirko Mileski" dhe Varrezat e reja të qytetit me sipërfaqe prej 110.000 m2 që gjenden në dalje të Kërçovës në Rrugën magjistrale drejt Manastirit.

Kapaciteti i Varrezave të vjetra të qytetit është më i mbushur dhe këto varreza përdoren vetëm për varrosjen e personave nga rrethi më i ngushtë i familjeve të bartësve të vendeve të varrimit që janë më të varrosur.

Për shkak të mosekzistimit të hapësirës së ndërtimit të fushave të reja të varreve, në vitin 2000 janë të lëshuara në përdorim varrezat e reja të qytetit në lokacionin e lartpërmendur. Varrezat ndërtohen, mirëmbahen dhe rikonstruohen në pajtim me Ligjin për varrezat dhe shërbimet e varrimit, me rregullat për ndërtim, me rregullat për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe me rregullat për mbrojtje shëndetësore dhe sanitare. Për varrezat është hartuar projekt për shpërndarjen e parcelave për vende varrimi, me të cilin projekt përcaktohen vende për varrim, vende të posaçme për varrim të qytetarëve të merituar, ose të personave të dalluar etj. Projektin e ka hartuar personi juridik që menaxhon me varrezat, ndërsa ky është NP "Komunalec" Kërçovë. Mirëmbajtja e varrezave përfshin mirëmbajtjen e:

- Objekte shoqëruese;
- Rrugë, rrugica dhe sipërfaqe të gjelbërta në varrezat;
- Pastërti publike të varrezave dhe varreve dhe
- Instalime.

Për mirëmbajtjen e varrezave, bartësi i vendit të varrimit, Udhëheqësit të varrezave i paguan taksë të varrimit në lartësi të shpenzimeve reale për mirëmbajtjen e varrezave.

1.1 Aktivitetet e punës

Udhëheqësi i varrezave të qytetit NP "Komunalec" Kërçovë organizohet ashtu që kryen veprimtari me të cilën siguron: efikasitet në punë, zhvillim dhe pajtim me zhvillimin e përgjithshëm të komunës, mbrojtje dhe avancim të të mirave nga interesi i përgjithshëm, plotësimin e nevojave të shfrytëzuesve të shërbimeve në mënyrë cilësore dhe në rregull. Në pajtim me dispozitat e reja të Ligjit për varrezat dhe shërbimet e varrimit, udhëheqësi me varrezat është i obliguar që ti kryej detyrat e punës vijuese dhe obligimet:

- Përgatitja e planit për rregullimin e varreve;
- Projekt për parcelizimin dhe mënyrën e shpërndarjes së vendeve të varrimit;
- Kryerje të operativave ndërtimore; ndërtim i fundamentit nga betoni, betonim dhe rregullim të hapësirës rreth vendeve të varrimit, ndërtim i mureve etj.
- Lidhja e kontratave me punëtorët e gurit për përpunim;
- Shitja e vendit të varrezave
- Ndërtim dhe rikonstruim të varreve me objekte shoqëruese;
- Udhëheqja e regjistrit për të gjithë personat e varrosur;

- Vendos dhe udhëheq evidencë të bartësve të vendeve të varrimit;
- Përcaktimi i lartësisë dhe pagesë për shpërndarjen e vendit të varrimit;
- Përcaktimi i lartësisë dhe pagesë të kompensimit për mirëmbajtjen e varreve;
- Përcaktimi i rendit dhe kohës së punës te varret dhe sigurimi i qetësisë.

Njësia për menaxhim me varrezat është pjesë e Njësisë punuese Higjiena Komunale.

Vendosja organizative e Njësisë për menaxhim me varrezat është si vijon:

- 1 Udhëheqës i njësisë – 1 realizues
- 2 Referent – 1 realizues
- 3 Punëtorë ndërtimorë – 3 realizues
4. Punëtor roje për mirëmbajtjen e varrezave- 2 realizues

Mjetet bazë me të cilat disponon NJ.P. Higjiena komunale, gjithashtu shfrytëzohen për kryerjen e punëve të nevojshme ndërtimore të njësisë janë:

- 2 maqina për përzierje të betonit;
- 3 maqina për kositje;
- 3 maqina dore për kositje.

Tabela vijuese ka të bëjë me numrin e varrimeve të kryera deri më datë 30.11.2021 në dy lokacionet e varrezave të qytetit:

	Varrime të kryera deri më dt. 30.11.2021
Varrimi i bartësit paraprak të Vendit të varrit në Varrezat e reja të qytetit	63
Varrimi i bartësit paraprak të Vendit të varrimit në Varrezat e vjetra të qytetit	44
Varrim në Varrezat e reja të qytetit – varr i ri	109
Gjithsej varrime të kryera	216
Gjithsej Kontrata për varrim	216

Deri më datë 30.11.2021, janë të kryera 216 varrime. Për dallim nga vitet paraprake, numri i përgjithshëm i varrimeve për vitin 2022 planifikohet të jetë rreth 235 varrime.

Gjatë vitit 2021 është filluar edhe ndërtimi i kapellës në rrethin e varrezave të reja të qytetit.

Përtej aktiviteteve të rregullta, gjatë vitit 2022 planifiohen të jenë të realizuara edhe aktivitete vijuese:

- Si një nga aktivitetet primare është ndërtimi i kapellës të varreve të reja;
- Adaptimi dhe përfundimi i objekteve ekzistuese për shfrytëzimin nga ana e qytetarëve;
- Ndërtimi i mureve;
- Betonimi rrugicave qasëse dhe vendeve ekzistuese të varrimit;
- Vendosja e kontejnerëve për mbeturina të përziara për zgjedhje dhe enë të reja për mbeturina;
- Mbjellja e sipërfaqeve me gjelbërim;
- Mbjellja e drunjëve të rinjë;
- Mirëmbajtje e rregullt e varrezave të qytetit (kositje, pastrim, mënjanimi i mbeturinave, sigurimi i rrugicave në kushte dimëri etj.)

TË ARDHURA	Shumë me 30.11 2021	Të planifikuara për 2022
Kompensimi për vendin e varrimit		
1	2.597.722,00	2.857.494,00
Të ardhurat nga kompenzimi për hyrje të gurëthyesit		
2	141.600,00	155.760,00
Të ardhura nga kompenzimi për hyrje të Operatorit-		
3	484.272,00	532.699,00
Të ardhura nga kompenzimi për mirëmbajtje të vendit të varrimit		
4	951.980,00	1.047.178,00
Gjithsej	4.175.574,00	4.634.887,00

SHPENZIME		Shuma me 30.11.2021	Planifikuar 2022
1	Shpenzime për varrimet	657.004.00	869.854.00
2	Paga për të punësuarit në njësi	2.250.683.00	2.380.217.00
Gjithsej		2.907.687.00	3.250.071.00

Nga rishikimet e mëparshme shihet se shpenzimet totale të njësisë janë 70% të të ardhurave totale, kështu që njësia me operimet e saj mbulon shpenzimet, dhe pjesa tjetër e fondeve do të investohet për të përmirësuar funksionimin e njësisë dhe ndërmarrjes.

8. SEKTORI MEKANIZIMI

Spektori Mekanizimi ka 6 realizues, prej të cilëve 1 udhëheqës, 1 mekanik - elektrikist, 3 auto-mekanik, saldator 1 KL.

Të punësuarit në Sektorin mekanizimi përveç punëve të përditshme siç janë lëshimi i urdhëresave rrugore, regjistrimit të automjeteve, evidencës së punëve të kryera nga çdo automjet NJP i mirëmbanë këto automjete, makina ndërtimore dhe pajisje ndihmëse:

-Automjete speciale për mbeturina- Mercedes AXOR-3

-Automjet Mercedes ATEGO kiper- 3

-Automjete speciale, Mercedes ATEGO-2

-Automjet special për mbeturina SCANIA-1

-Automjet special për mbeturina DAF-1

-Mercedes- cisternë për fekalë-1

-Mercedes- cisternë për ujë- 1

-Mercedes sanduçar-1

-Fiat DUCATO-1

- FORD Tranzit-1
- PEUGEOT PARTNER (pikap)-1
- PEUGEOT PARTNER (pikap)-1
- PEUGEOT PARTNER (pikap)-1
- CITROEN BERLINGO (pikap) -1
- MAHINDRA amp -1
- MAZDA BT-1 amp pikap
- NISAN NAVARA-1
- LADA NIVA-1
- HONDA CR-V- 1 jeep
- Automjet special për mbeturina FAP-1
- JCV vemje i vogël- 2
- Eskavator me vemje-1
- Makinë univertzale JCV 4 CX-2016 -1
- Makinë univertzale- JCV 3CX- 2
- Makinë univertzale HIDROMEK-1
- GËRMUES KASSE -1
- Traktor IMT 549-1
- Traktor IMT 539- 1
- Traktor John Deer- 1 rimorkio për traktor
- Traktor Mahindra me rimorkio- 1
- Traktora TAFE- 2

Dy rimorkio për bartjen e minieskavatorëve, solarit për traktor dhe solar univerzal për automjete, katër plugje për makina univerzale dhe dy daska për traktorë.

Si qëllim për zhvillim të Sektorit mehanizimi për vitin 2022 është planifikuar si vijon:

- Ndërtimi i garazhit të ri dhe rindërtimi i së vjetrit për servis të automjeteve të rënda dhe të lehta si dhe furnizim me pajisjet si vijojn
- Program për diagnostifikimin e automjeteve
- Boca oksigjeni me elemente mbështetëse
- Makinë statike për shpuarje
- Plotësimi i veglave të vjetra

Qëllimi: Furnizim me pajisje për kryerje më efikase, më ekonomike dhe më të shpejtë të detyrave të punës që të shmangen shpenzimet për kosto të punëve të caktuara që për shkak të mungesës së pajisjeve duhet të kryhen nga ana e personave ose kompanive tjera.

Poashtu në vitin 2022 propozojmë që të vazhdohet trendi për rinovimin e parkut vozitës me automjete të reja me qëllim zvogëlimi të mirëmbajtjes së automjeteve të vjetra.

Edhe në vitin 2022 propozojmë që të vazhdohet me trendin për rinovimin e parkut vozitës me automjete më të reja me qëllim për uljen e shpenzimeve për mirëmbajtje të automjeteve të vjetra.

**NP "KOMUNALEC"- KËRÇOVË
DREJTOR**
